

Dr. Vehbetu Zuhejli

Pasimi

XVIII

Pjesë e shkëputur nga “Usuli fikhu islam”

Autori:
Dr. Vehbetu Zuhejli

Përktheu:
Dr. Musli Vërbani

Titulli:
Pasimi

Korrektura:
Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Hyrje

Të angazhuarit me shkencë dhe arritja e shkallës së nivelit shkencor nuk është çështje e të gjithëve.

Në çdo shoqëri ekzistojnë dijetarë të caktuar për një çështje të caktuar, e që pastaj njerëzit i pasojnë dhe i shfrytëzojnë idetë e tyre, veprojnë me idetë e tyre dhe rezultatet e punës së tyre. Kështu është çështja e të kuptuarit të sheriatit islam. Kemi muxhtehidë të cilët paraqesin të arriturat e tyre shkencore, ashtu siç kemi pjesën më të madhe të cilët pasojnë dijetarët eminent. Pasi që kam sqaruar çështjet të cilat ndërlidhen me ixhtihadin, më duhet të ndriçoj edhe çështjen e pasimit. Për pasimin dhe fetvanë do të flas në Temat si në vijim:

Tema e parë:

- Definicioni i pasimit;
- Historia e pasimit;
- Dallimi ndërmjet pasimit dhe ndjekjes.

Tema e dytë:

- Sfera e pasimit;
- Dispozita e pasimit;
- Llojet e pasimit; dhe
- Sqarimi i pasuesit.

Tema e tretë:

- Përmbajtja e pasuesit në një medhheb të caktuar.

Tema e katërt:

- Përzierja (TELFIKI) e medhhebeve; dhe
- ndjekja e lehtësimeve.

Tema e pestë:

- Çka ekziston në mes të pyetësit dhe muftisë; dhe
- kushtet e të pasuarit.

Tema e parë

- **Definicioni i pasimit,**
- **Historia e pasimit,**
- **Dallimi ndërmjet pasimit dhe ndjekjes.**

Definicioni i pasimit

Gjuhësisht, *taklidë* do të thotë ***vendosja e frerit në fyt***, siç është rasti tek përcjellja e kurbanit në haxh, pra vendosja e frerit në fyt, e që më pastaj me të përcillet kafsha shtëpiake deri te vendi i therjes.

Kurse në terminologjinë e usulit, ***pranimi i mendimit të tjetrit pa e ditur argumentimin e tij***,¹ që do të thotë, mbështetja te tjetri si në veprim ashtu edhe në mosveprim, siç është rasti te lëmimi i një pjese të kokës duke pasuar Shafijët dhe mosleximi i Fatihasë në namaz për muktediun, duke vepruar në bazë të mendimit të Ebu Hanifes, e të ngjashme.

Historia e pasimit

Dukuria e pasimit ka filluar në fillim të shek. të IV h.

Shevkaniju thotë: ***“Deri sa kanë përfunduar gjeneratat më të mira (të arta) nuk ka ndodhur dukuria e pasimit, por ka ndodhur pastaj te gjenerata tjetër pas tyre.***

Të përmbajturit e një medhhebi nga katër medhhebet ka filluar pas përfundimit të shek. të IV.

Dijetarët e medhhebeve kanë qenë shembull që të mos pasohen të parët para tyre dhe të mos llogariten (ata para tyre), mirëpo këto katër medhhebe i kanë paraparë njerëzit e rëndomtë nga vetja e tyre duke mos pasur leje nga imamët muxhtehidë të medhhebeve të tyre.²

Dallimi ndërmjet pasimit dhe ndjekjes

Siç sqaruam më herët, te shumica e madhe e dijetarëve, pasimi nuk është i njëjtë me ndjekjen:

- **pasim** është pranimi i mendimit prej tjetrit pa (kërkuar) argument. përderisa,

- **ndjekja**, nënkupton ndjekjen e rrugës së të ndjekurit dhe marrja e ligjit me argument në të njëjtën mënyrë siç e ka marrë i ndjekuri. Ai e ndjek mendimin e mendimtarit në bazë të asaj siç e sqaron prej argumentit për ta saktësuar dhe vërtetuar mendimin e tij. E kjo është e kundërta e pasimit të llojit kur një person i tregon personit tjetër duke mos e kuptuar argumentin dhe duke mos e ditur kuptimin.³

Zoti i Lartmadhëruar, në shumë ajete pasimin e ka treguar si çështje të urryer. Prej tyre, ajeti:

اتَّخَذُوا أَحْبَارَهُمْ وَرُهَبَانَهُمْ أَرْبَابًا مِّن دُونِ اللَّهِ

“Ata i konsideruan ahbarët (*priftër jehudi*) e tyre, ruhbanët (*murgjit e krishterë*) e tyre, për zota pos All-llahut.” (Et-Tevbe : 31)

Ideja është që të pasohet argumenti dhe ndërlidhja me argument, duke mos u pasuar konkretisht vetëm njeriu, sepse në bazë të shariatit pasimi është i ndaluar.

Mirëpo, siç do ta sqaroj, ndalesa e pasimit është për atë i cili është muxhtehidë, përderisa njeriu i rëndomtë duhet që ta pasoj tjetrin, përderisa sa i përket ajetit të sipërpërmendur, ai ka të bëjë me urrejtjen e pasimit në çështje të besimit.

Tema e dytë

- **Sfera e pasimit,**
- **Dispozita e pasimit,**
- **Llojet e pasimit dhe**
- **Sqarimi i pasuesit.**

Ligjet e sheriatit:

- ose janë ligje të cilat ndërlidhen me bazat,
- ose me çështje të besimit,
- ose janë ligje të cilat ndërlidhen me veprimet dhe çështjet sekondare.

Pasimi në çështje të besimit ose në bazat kryesore

Çështjet e bazave të besimit dhe bazave kryesore, si f.v., njohja e Allahut të Lartmadhëruar, cilësitë e Tij, argumentet e pejgamberisë, çështjet e moralit dhe çdo gjë që në fe njihet si domosdoshmëri e obligimeve të sheriatit si, në adhurime, marrëdhënie reciproke ose në vepra penale, ose në ndalesa, ose në pesë shtyllat e islamit, ndalesa e alkoolit, ndalesa e prostitucionit, lejimi i shitblerjes, lejimi i kurorëzimit, e të ngjashme,

- në këto duhet pasur mbështetje në logjikë dhe në studim dhe jo vetëm pasim dhe përngjasim ndaj tjerëve.

- Abdullah bin el Hasan el Uvejriju, hashevijtë dhe tealimijtë deklarojnë⁴ se *lejohet pasimi në to*.

- disa deklarojnë se për njeriun pasimi është obligim, ndërsa studimi dhe ixhtihadi në to është haram.⁵

Shumica absolute e dijetarëve argumentohen si në vijim:

E para: Studimi është vaxhib, ndërsa në pasim është anashkalimi i vaxhibit andaj kjo nuk lejohet. Argumenti i obligueshmërisë së vështtrimit është thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ

“Pa dyshim se në krijimin e qiejve dhe tokës...” (El Bekare : 164)

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Mjerë për atë i cili e lexon këtë ajet dhe nuk analizon.”**⁶ Pejgamberi s.a.v.s., pra ka kërcënuar që të mos anashkalohet vërtetimi (studimi), analiza dhe hulumtimi në ajetet e Allahut. Kjo dëshmon se hulumtimi është vaxhib.

E dyta: Dijetarët janë pajtuar për atë se njohja e Allahut është vaxhib, çka lejohet dhe çka nuk lejohet në të (fe), dhe kjo nuk realizohet vetëm me pasim, sepse pasuesi pranon vetëm atë çka i thuhet prej të pasuarit dhe kësisoj pasuesi nuk e di a është çështja e drejtë apo jo. Ekziston mundësia që i pasuari të gënjejë dhe kësisoj humb edhe pasuesi.

Ata të cilët e lejojnë pasimin argumentohen si në vijim:

E para: Po të ishte vështirë vaxhib, këtë do ta vepronin sehabet dhe do të urdhëronin për të, mirëpo ata nuk e kanë bërë këtë, po ta kishin vepruar, atëherë do të na ishte raportuar ashtu siç është raportuar për çështjet sekondare të fikhut.

Replikë ndaj asaj se ata nuk kanë analizuar është se njohja e tyre në çështjen e besimit është e ndërtuar mbi bazën e argumentimit. E vërteta e çështjes është se nuk kanë pasur nevojë që të hulumtojnë për shkak se atyre u ka mjaftuar mendimi i tyre i pastër dhe mbështetja e tyre në perceptimin e shëndoshë dhe në dëshminë e shpalljes.

Po ashtu, ne nuk e pranojmë faktin se ata nuk kanë qenë të urdhëruar për vështirë dhe hulumtim sepse me fjalën hulumtim nuk është qëllimi vetëm shpjegimi i çështjeve të rregullave logjike në krahasimin e çështjeve dhe formave të njohura, por mjafton ajo çka të krijon përshtypjen dhe bindjen. Ai i cili shikon njerëzit e rëndomtë do të hasë argumente të mjaftueshme prej tyre për besimin e vërtetë të tyre, të cilën e tregojnë ngjarjet dhe dëshmitë në vazhdimësi, saqë nuk e gjen asnjë se është pasues në besim (iman) sepse sendet lëndore të gjithësisë dhe lëvizjet në natyrë, në shpejtësi të japin argument se ekziston një Krijues i gjithësisë, e kjo shprehet deri në atë shkallë sa te shumica e njerëzve të rëndomtë besimi është i ngulitur në gjokset e tyre si shkëmb i pashembur.

E dyta: Po të ishte vështrimi i njohjes së Allahut vaxhib, do të na shpinte në rotacion,⁷ sepse obligushmëria e vështrimit i urdhëruar prej Allahut, ka të bëjë me njohjen e Allahut, ndërsa njohja e Allahut ka të bëjë me vështrimin për njohjen e Allahut.

Replikë – Këtu nuk kemi të bëjmë me rotacion sepse obligimi i vështrimit ligjor qëndron në njohjen e Allahut nga një këndvështrim, ndërsa njohja e Allahut ka të bëjë me vështrimin e përsosmërisë (që nënkupton atë çka i përket dhe çka nuk i përket Atij). Kështu që ajo çka është vaxhib vështrimi në njohjen e Allahut është ndryshe nga njohja e cila rezulton prej vështrimit.

Përfundim – Pasimi në çështjet e besimit nuk është rrugë për dituri, pa dyshim, sepse me fjalën *dituri* qëllimi është për bindjet, përderisa bindja duhet të përputhet me realitetin e argumentuar me argument, ndërsa pasimi nuk ka të bëjë me këtë sepse nënkupton pranimin e mendimit të tjetrit pa e argumentuar, siç e thotë Gazaliu.⁸

Sa i përket atyre të cilët thonë se pasimi është vaxhib dhe e anashkalojnë vështrimin, ata argumentohen me dy argumente:

Argumenti i parë:

Vështrimi është çështje e të dyshimtës e cila të shpie në dyshime dhe në hamendësi për anomali dhe mendime që sjellin në besëtytni, e që e kundërta është te pasimi, e cila është rrugë e sigurimit nga iluzionet dhe besëtytnitë, e për këtë arsye duhet të merret ajo çka është më e sigurt se tjetra, e cila është e pasigurt, për këtë arsye duhet marrë parimin e pasimit.

Replikë – Nëse është i patjetërsueshëm ndalimi për vështrim (studim), atëherë është e patjetërsueshme edhe ndalimi në pasim. Kështu që ky argument është vetë kundërgargument. Argument për këtë është se Zoti i

Lartmadhëruar ua ka tërhequr vërejtjen një populli që të mos pasojnë paraardhërist e tyre, saqë edhe i ka kritikuar, kur ka thënë:

إِنَّا وَجَدْنَا آبَاءَنَا عَلَىٰ أُمَّةٍ وَإِنَّا عَلَىٰ آثَارِهِم مُّقْتَدُونَ

“Ne i gjetëm të parët tanë në këtë fe dhe ne jemi të orientuar gjurmëve të tyre.” (Ez-Zuhruf : 23)

Po ashtu, studimi për çështje të cilat sjellin dyshim dhe pasiguri janë dyshime të pavlefshme, ndërsa në këtë rast kemi të bëjmë me studimin e vlefshëm, ndërsa studimi i drejtë (i vlefshëm) përfundimin e ka të sigurt.⁹

Argumenti i dytë:

Vështrimi është i ndaluar edhe me Kur'an edhe me sunet. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

مَا يُجَادِلُ فِي آيَاتِ اللَّهِ إِلَّا الَّذِينَ كَفَرُوا

“Rreth argumenteve të All-llahut nuk kundërshton kush, pos atyre që nuk besuan.” (Gafir : 4)

Studimi shpie deri te hapja e derës së polemikave, për këtë arsye është i ndaluar. Pejgamberi s.a.v.s. i ka ndaluar sehabet atëherë kur i ka dëgjuar se bisedonin për çështjen e kaderit, duke u thënë: **“Gjeneratat para jush janë shkatërruar sepse janë zhytur në këtë çështje.”**¹⁰

Replikë – Sa i përket asaj se ajeti ndalon për polemikat për çështje të pavlefshme, argument për këtë është thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَجَادِلُوا بِالْبَاطِلِ لِئُدْحِضُوا بِهِ الْحَقَّ

“...ashtu me ato deshi ta likuidoje të vërtetën.” (Gafir : 5)

Ndërsa polemika për çështje të vlefshme është e lejuar. Këtë e thotë Zoti i Lartmadhëruar:

وَجَادِلْهُمْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ

“...polemizo me ata (kundërshtarët) në atë mënyrë që është më e mira...” (En Nahl : 125)

Po të ishte polemika e drejtë e ndaluar, nuk do të kishte qenë e urdhëruar. Zoti i ka lavdëruar ata të cilët vështrojnë, kur thotë:

وَيَتَفَكَّرُونَ فِي خَلْقِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ

“Dhe analizojnë dhe studiojnë krijimin e qiejve dhe tokës.” (Ali Imranë : 191)

Përderisa, ndalesa e pejgamberit s.a.v.s. për zhytjen në çështjen e kaderit është e vlefshme nga shkaku se atyre u ka treguar me tekst dhe i ka ndaluar që të merren më tutje me të, sepse polemika për kaderin nuk ka qenë polemikë e drejtë.¹¹

Pasimi në çështjet dytësore

Ligjet për çështjet praktike, të cilat vërtetohen në mënyrë të sigurt, janë sferë për të cilën është e drejtë të bëhet ixhtihadë, dhe të pasohen. Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme për dispozitën e pasimit në çështjet dytësore, e unë i kam zgjedhur disa prej tyre, e ato janë:

E para: Mendimi i dhahirijëve, muëtezilëve të Bagdadit dhe një pjese të imamijëve, është se **ixhtihadi është i domosdoshëm**, ndërsa pasimi nuk lejohet. Secili njeri (i ngarkuar) duhet që për çështjet e fesë së tij të bëjë ixhtihadë vet dhe të veprojë ashtu siç rezulton prej ixhtihadit të tij.¹²

Në librin “En-Nebdhul Kafijeti fi ilmil usul”, Ibn Hazmi thotë se, **pasimi është haram**. Asnjëri nga askush nuk duhet të marrë mendimin pa

argument, përpos prej të dërguarit të Allahut sepse Zoti i Lartmadhëruar thotë:

اتَّبِعُوا مَا أُنْزِلَ إِلَيْكُم مِّن رَّبِّكُمْ وَلَا تَتَّبِعُوا مِن دُونِهِ أَوْلِيَاءَ

“Pasoni atë që ju është zbritur nga Zoti juaj, e mos merrni miq pos Tij...” (El Earaf : 3)¹³

Në librin **“El Ihkamë”** thotë: “Pasimi, në tërësi në të gjitha ligjet është haram, nga e para deri te e fundit, duke filluar nga tevhidi, pejgamberia, çështja e imamit, vlefshmërisë dhe në të gjitha adhurimet dhe ligjet, etj.”¹⁴

Ibn Arabiu thotë: “Te ne, pasimi në fenë e Allahut nuk është i lejuar, as prej të gjallit dhe as prej të vdekurit. Pyetësi, kur ta pyes dijetarin duhet ta përcaktoj duke e pyetur: Për këtë çështje dëshiroj ta di se çka gjykon Allahu ose si gjykon i dërguari i Tij, etj.”¹⁵

E dyta: Mendimi i hashuvijëve dhe tealimijëve, siç e treguam edhe më herët është se, hulumtimi dhe ixhtihadi nuk lejohen dhe **pos imamëve muxhtehidë, për të tjerët pasimi është vaxhib.**¹⁶

E treta: Medhhebi i cili bën dallimin. Të këtij mendimi janë shumica e pasuesve të katër medhhebeve. E që është, ixhtihadi nuk është i ndaluar dhe pasimi është haram për muxhtehidin, kurse vaxhib për muslimanin e rëndomtë, pra është vaxhib për atë i cili nuk e ka arritur nivelin që të jetë kompetent për ixhtihadë edhe nëse është dijetar.¹⁷

Këtë mendim e përkrahin shumica e analistëve, të cilët argumentohen si në vijim:¹⁸

1. **Argument nga Kur’ani:** Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

فَاسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

“Ju pyetni pra dijetarët nëse ju nuk dini.” (En Nahl : 43)

Ky tekst është i përgjithshëm për secilin dhe për çdo çështje e cila nuk dihet sepse urdhërori është i përcaktuar për shkak të mosdijes, i cili përsëritet me përsëritjen e saj dhe në çdo rast të mosdijes personi urdhërohet të pyes, dhe siç thotë Amediu, minimumi i shkallës së thënies së Zotit të Lartmadhëruar “dhe pyetni” është lejimi.

2. **Ixhmai i sehabeve dhe tabiinëve.** Ata jepnin fetva para masës së njerëzve të cilët pyesnin për ndonjë rast apo ngjarje, dhe asnjëri prej tyre nuk refuzonte dhe nuk i ndalonte njerëzit që të pyesin, dhe ata nuk i urdhëronin njerëzit që të arrijnë nivelin e muxhtehidit. Kjo është çështje e cila njihet si domosdoshmëri dhe plotësim i dijetarëve me të rëndomtit.

3. **Argumenti logjik.** Ixhtihadi është një çështje të cilën mund ta arrijnë vetëm një numër i vogël i njerëzve, dhe nëse obligohen të gjithë njerëzit, atëherë do të ishte obligim i papërballueshëm dhe kjo ligjërisht është e ndaluar në bazë të thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا

“All-llahu nuk ngarkon askënd përtej mundësive të veta.” (El Bekare : 286)

Nga ana tjetër është ajo se, njerëzit e rëndomtë janë të obliguar me ligjet e sheriatit, ndërsa ngarkesa e tij që të arrij nivelin e ixhtihadit është lodhje, mundim dhe vështirësi, sepse ai është i angazhuar për jetën e kësaj bote dhe

po të angazhohej për ixhtihadë do të neglizhoheshin profesionet tjera dhe veprimtaritë tjera dhe interesat e ndryshme të domosdoshme të cilat do të duhej t'i kryenin dhe sistemi jetësor do të ndryshonte. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَمَا جَعَلَ عَلَيْكُمْ فِي الدِّينِ مِنْ حَرَجٍ

“(Allahu) nuk ka bërë në fe asgjë të vështirë për juve.” (El Haxh : 78)

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Në islam, as mos dëmtoni dhe as mos u dëmtoni.”**¹⁹

Këto argumente janë kundërshtuar me argumente tjera prej Kur'anit dhe prej sunetit dhe me argument logjik, të cilat janë të vlefshme si argument i medhhebit të parë të cilët e ndalojnë pasimin.²⁰

Sa i përket Kur'anit, thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَأَنْ تَقُولُوا عَلَى اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ

“...dhe ju shtyn të thoni për All-llahun atë që nuk e dini.” (El Bekare : 169)

Mendimi pro pasimit është thënie që qon në pasim të asaj që nuk dihet dhe kjo është e ndaluar. Po ashtu Zoti i Lartmadhëruar e ka kritikuar pasimin kur ka treguar për një popull:

إِنَّا وَجَدْنَا آبَاءَنَا عَلَىٰ أُمَّةٍ وَإِنَّا عَلَىٰ آثَارِهِم مُّقْتَدُونَ

“Ne i gjetëm të parët tanë në këtë fe dhe ne jemi të orientuar gjurmëve të tyre.” (Ez Zuhruf : 23)

E, e kritikuara nuk mund të jetë e lejuar.

Replikë ndaj ajetit të parë – Ai ajet përmban gjithashtu edhe hulumtimin edhe ixhtihadin në çështje të ixhtihadit dhe dihet se ixhtihadi është veprim me të pasigurtën, ndërsa ajeti tregon që të veprohet me atë çka është e sigurt dhe bindëse, dhe përfshinë ndalesën e ixhtihadit në mënyrë absolute.

Replikë ndaj ajetit të dytë – Ajeti i kritikës ndaj pasimit (taklidit) ka të bëjë për ato çështje që kërkohet njohuri, e prej atyre çështjeve janë çështjet e besimit, kështu bëhet pikëbashkimi me argumentet e mëparshme të cilat i përmendëm.

Argument nga suneti

Thënia e pejgamberit s.a.v.s.: **“Kërkimi i diturisë është obligim për çdo musliman.”**²¹

Dhe thënia e pejgamberit s.a.v.s.: **“Bëni ixhtihadë sepse çdo lehtësim është bërë për ndonjë njeri i cili mund të ketë qasje në atë lehtësim.”**²²

Këto dy tekste janë tekste të përgjithshme për personat dhe për çdo dituri. Këto tekste tregojnë për obligueshmërinë e hulumtimit.

Replikë ndaj hadithit të parë – Të gjithë janë të pajtimit se kjo nuk është bosht i debatit sepse fjala *dituri* (d.m.th. bindja) nuk është e kërkuar as në ixhtihadë dhe as në pasim, dhe për këtë ekziston edhe ixhmai.

Sa i përket hadithit të dytë, ka të bëjë me atë i cili nuk e ka arritur nivelin e ixhtihadit, kjo kur të bëhet bashkimi në mes të këtyre haditheve dhe argumenteve tjera, të cilat i përmenda më herët.

Argumenti logjik

Poqëse njerëzit e rëndomtë do të urdhëroheshin për të qenë pasues, ata nuk do të kishin besim në veten e tyre pasi ata nuk e dinë se ai të cilin e pasojnë a ka gabuar apo jo në ixhtihadin e vet, ose a është gënjeshtar për lajmin të cilin e pranon, e atëherë njerëzit e rëndomtë do të urdhëroheshin të pasojnë gabimin dhe gënjeshtren, dhe kjo është e papranuar t'i përshkruhet Ligjvënësit.

Replikë – Kur njeriu i rëndomtë të bëj ixhtihadë edhe ne nuk do të ishim të sigurt në veten tonë se a ka gabuar ai apo jo, bile ai është edhe më afër gabimit, për shkak se nuk ka kompetencë, e atëherë ndalesa është e njëjtë për të dy rastet.

Llojet e pasimit

Nga vet fjala *pasim* rezulton se pasimi është dy llojesh:

- **Pasimi i urryer,**
- **pasimi i pëlqyer.**

Pasimi i pëlqyer – Është pasimi për atë i cili nuk ka aftësi të bëj ixhtihadë, sepse ai nuk mundet vet të arrij te dispozita e sheriatit dhe nuk i mbetet zgjidhje tjetër përpos që ta pasoj atë i cili e drejton prej kompetentëve të ixhtihadit, për çështje çka e ka obligim prej obligimeve.

Sa i përket pasimit të urryer - Pasimi i urryer është tri lloje:

E para: Ajo çka është në kundërshtim me atë që ka zbritur Allahu dhe që nuk interesohen për të, si f.v., pasimi i prindërve dhe prijësve.

E dyta: Pasimi i atij për të cilin pasuesi nuk e di se a është ai kompetent për t'u pasuar dhe se a duhet marrë mendimi i tij.

E treta: Pasimi pasi që të paraqiten argumentet dhe qëndrueshmëria e argumentit të personi në kundërshtim me mendimin e të pasuarit.

Këto tri nënloje janë ato për të cilat kanë zbritur ajetet dhe hadithet me tematikë kritikën e pasimit, për të cilën kanë pasuar për qëllim, kur është thënë pasimi prej tyre. Imamët e katër medhhebeve kanë thënë të mos pasohen ata (në këto lloje të pasimit) dhe i kanë kritikuar,²³ dhe kanë kërkuar që të mos pranohen mendimet e tyre pa qenë të argumentuara.

Shafiiju ka thënë: *“Shembulli i atij i cili kërkon dituri pa argument i ngjanë shembullit të atij i cili punon natën (në terr).”*

Ahmedi ka thënë: *“Mos më ndiqni dhe mos pasoni mbret e as pasanik, dhe shpërndarësen, merrni nga kanë marrë ata, pastaj ka thënë, është i cekët në perceptim njeriu i cili në fenë e tij i pason njerëzit.”*

Ebu Jusufi ka thënë: *“Asnjërit nuk i lejohet t'i thotë fjalët (mendimet) tona deri sa ta mëson se nga i kemi marrë.”*

Sujutiu ka thënë: *“Vazhdimisht dijetarët e së kaluarës dhe të tashmes urdhërojnë për ixtihadin dhe nxisin për të dhe pasimin e ndalojnë, e kritikojnë dhe e urrejnë.”*

Një pjesë e dijetarëve kanë shkruar libra në kritikë të pasimit, si f.v., autori Mezeniju, pastaj Ibni Hazmi, Ibni Abdul Berri, Ebi Shametu, Ibni Kajim el Xhevziju dhe autori i “Kamusul Muhitë”.²⁴

Karafiju ka thënë: *“Medhhebi i Malikut dhe shumicës absolute të dijetarëve është obligueshmëria e ixhtihadit dhe ndalimi i pasimit.”*²⁵

Pasuesi

Këtu bën pjesë edhe domosdoshmëria e përkufizimit të nivelit arsimor për dispozitën e pasimit dhe kush ka të drejtë të pasoj. Kjo kuptohet prej asaj që kemi përmendur më lartë se, shumica absolute e dijetarëve të usulit thonë se, **pasues është ai i cili është absolutisht njeri i rëndomtë** dhe se ai duhet të pasoj në çështjet dytësore të sheriatit të konfirmuara nëpërmjet rrugës së pasigurt,

- po ashtu, kjo përfshinë edhe dijetarin i cili ka studiuar disa dituri të cilat pranohen si çështje të përfituara prej ixhtihadit, mirëpo ai nuk e ka arritur nivelin e ixhtihadit.

Këta dy duhet të pasojnë mendimet (thënit) e muxhtehidëve dhe përgjigjet e tyre. Kjo nga shkakun se njeriu i rëndomtë nuk ka njohuri për çështjet të cilat shpijnë deri te ixhtihadi, e këtu hyn edhe ai dijetar i cili nuk ka aftësi për ixhtihadë, kështu edhe ai edhe njeriu i rëndomtë duhet të pasojnë.²⁶

Disa muëtezil të Bagdadit thonë se, as njeriu i rëndomtë dhe as dijetari i cili nuk është kompetent për ixhtihadë nuk lejohen të pasojnë asnjë prej muxhtehidëve, por secili prej tyre duhet të mësoj dispozitën me argument.

Ebu Ali el Xhebajju ka thënë: **“Lejohet pasimi (taklidi) në çështjet e ixhtihadit.”** si f.v., pastrimi i papastërtisë me ujë, por jo në çështjet

tekstuale si f.v., obligueshmëria e namazit, zekatit, haxhit, agjërimit, e të ngjashme.

Ne edhe më herët i kemi treguar këto çështje me argumente, e kjo në temën ***“dispozita e pasimit në çështjet sekondare”***.

A duhet të pasoj muxhtehidi?

Muxhtehidë është ai i cili posedon aftësi për ixhtihadë dhe përfitim të ligjeve. Ne e kemi kuptuar se shumica absolute e dijetarëve deklarojnë se, muxhtehidi e ka të ndaluar ta pasoj tjetrin. Dijetarët e njohur, kur janë deklaruar pro ndalimit të pasimit, kanë pasur për qëllim ndalimin e pasimit për muxhtehidët dhe nuk e kanë pasur për qëllim pasimin (taklidin). Muxhtehidi e ka të ndaluar që ta lë mangë (neglizhoj) fenë e tij.²⁷

Mund të parashtrohet pyetja, muxhtehidi pasi që të plotësoj kushtet e ixhtihadit, deri në cilën masë ka nevojë që të pasojë?

Përgjigja është, duhet të bëhet dallimi si në vijim:²⁸

- Muxhtehidi, ose ka bërë ixhtihadë ose jo.

- Nëse ka bërë ixhtihadë për një çështje dhe ka arritur të finalizojë një dispozitë prej dispozitave si f.v., *është vaxhib*, të gjithë janë të pajtimit se nuk lejohet të pasoj tjetrin atëherë kur mendimi i tij është në kundërshtim me mendimin e tjetrit, dhe nuk lejohet ta anashkalon mendimin e tij dhe ta pason mendimin e tjetrit. Por,

- nëse për një çështje nuk bën ixhtihadë, për këtë dijetarët janë ndarë në tetë drejtime:

1. Nuk lejohet në mënyrë absolute. Të këtij drejtimi janë Gazaliu, Amediu, Bejdaviju dhe shumica e dijetarëve.

2. **Lejohet në mënyrë absolute.** Të këtij mendimi janë Ahmed bin Hanbeli, Is'hak bin Rahuvijhi dhe Sufjan eth-Thevriju.

3. **Lejohet, për atë që është ligj prej ligjeve që ka të bëjë posaçërisht për veten e tij dhe nuk lejohet të jep fetva për të tjerët.** Këtë mendim e kanë disa banorë të Irakut.

4. **Lejohet, nëse frikësohet se e humb kohën e tij po të angazhohej me ixhtihadë, ndërsa nuk lejohet nëse nuk e humb kohën e tij,** ose që është posaçërisht vetëm për vetën e tij, siç tregon Amediu, të këtij mendimi janë disa Irakianë tjerë.

5. **Lejohet pasimi i tjetrit, nëse ai është më i ditur se vet dhe nuk lejohet nëse është i rangut të tij apo i rangut më të ulët se i tij.** I këtij drejtimi është Muhamed bin el-Hasani dhe e ka përzgjedhur Ibn Haxhibi.

6. **Lejohet të pasohet sehabiju,** nëse ai është më favorit se tjetri dhe nuk lejohet i tjetrit. Kjo është raportuar nga Shafiiu.

7. **Lejohet të pasohen sehabet dhe tabiinët,** ndërsa të tjerët jo.

8. **Lejohet pasimi i më të diturit me kusht që ai të mos ketë pasur mundësi të bëjë ixhtihadë.** I këtij mendimi është Ibni Serijxhi.

Unë e përzgjedh mendimin e parë, i cili ishte se, absolutisht nuk lejohet që muxhtehidi të pason muxhtehidin tjetër, sepse çështja për pasimin është për atë i cili mund të gabojë ndonjë dispozitë të sheriatit i cili nuk aprovohet pos me argument prej tekstit ose të analogjisë me tekstin, ose që në esencë është joargumenti dhe kush pretendon diçka tjetër nevojitet ta sqarojë. Lejimi i pasimit të njeriut të rëndomtë nënkupton se, ai nuk ka aftësi të arrij deri te e kërkuara prej dispozitës, ndërsa nuk nënkupton që lejohet për atë i cili ka kompetencë të ixhtihadit dhe mund të arrij vet deri te dispozita, pasi ai veç ka aftësi për ixhtihadë. Besueshmëria në vete është më e plotë se sa besueshmëria ndaj atij të cilin e pason.

Përpos kësaj, muxhtehidi është i urdhëruar të analizoj, pasi Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Dhe analizoni o ju të zotët e mendjes.”**

Po të lejohej pasimi prej tij, do të nënkuptohej të anashkalohej ajo që e ka për detyrë (vaxhib), ndërsa lënia e vaxhibit është haram.²⁹

Përderisa, ata të cilët e lejojnë pasimin, argumentimet e tyre janë absolutisht të dobëta.³⁰

E para: Kur’ani.

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

فَاسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

“Ju pyetni pra dijetarët nëse ju nuk dini.” (En-Nahl : 43)

Në këtë rast, muxhtehidi nuk ka dije për çështjen për të cilën pyet, kështu që është i urdhëruar të pyet më të diturin. Minimumi i urdhrit është lejimi, atëherë *të pyeturit e tjetrit* për të është *e lejuar*.

Replikë: Ajeti ka të bëjë për njeriun e rëndomtë, sepse ai e ka atributin se nuk është dijetar prandaj e pyet tjetrin i cili është kompetent. Përderisa, ai i cili e ka gradën e të diturit, nuk përfshihet në ajet, pasi që pyetësi nuk ka nevojë më shumë se i pyeturi.

E dyta: Ixhmai.

– Rastet kur Umeri është kthyer në mendimin e Aliut dhe në mendimin e Muadhit, dhe AbduRrahman bin Aufi e ka pranuar Uthmanin në pasimin e drejtimit të dy udhëheqësve, Ebu Bekrit dhe Umerit r.a., dhe nuk e ka kundërshtuar asnjëri prej sehaveve edhe pse pasuesi ka pasur kompetencë për ixhtihadë, kështu që është aprovuar ixhmai.

Replikë – Umeri r.a. nuk ka qenë pasues i drejtimit të Muadhit dhe të Aliut, por e ka kuptuar argumentin e paraqitur prej tyre, dhe e ka parë si obligim të kthehet në mendimin e tyre.

Përderisa sa i përket rrugës së dy shejhave, në besatimin e Abdurrahmanit për Uthmanin r.a., ky ka qenë qëndrim i të drejtës dhe tolerancës ndërmjet njerëzve dhe largim i dashurisë ndaj kësaj bote dhe nuk është pasim i dy shejhave në dispozita të ixhtihadit.

Kjo dhe, Ibni Kajimi i ka përmendur dy mendime rreth çështjes, *a lejohet muxhtehidi i një medhhebi të jep fetva me mendimin e atij imami?*, ato janë dy paraqitjet e Shafiiut dhe Ahmedit. E para thotë se lejohet dhe e dyta thotë se nuk lejohet të jep fetva.

Pastaj Ibni Kajimi thotë: “E vërteta është se, duhet të bëhet dallimi, nëse pyetësi thotë, *dëshiroj që për këtë çështje të jepet gjykimi i Allahut dhe e dëshiroj të vërtetën e cila më qetëson*, e të ngjashme, nuk ka alternativë tjetër pos që të bëj ixhtihadë dhe nuk lejohet të jep fetva vetëm duke e pasuar tjetrin, pa e ditur se a është e vërtetë apo jo. Nëse i thuhet, *për këtë çështje dua të di mendimin e imanit të medhhebit*, atëherë e thotë atë që është thënë prej tyre dhe e raporton mendimin e tyre, pastaj i mbetet pyetësit që ta kuptoj pjesën tjetër. Në rastin e parë, perceptimi është për të pyeturin, në rastin e dytë për pyetësin.³¹

Mendimi im (i autorit) për pasimin

Askush nuk mund ta injoroj mendimin kritik, të ashpër dhe sulmin ndaj pasimit që është bërë prej shumicës së dijetarëve, si f.v., Ibni Hazmi, i cili pjesën më të madhe të vëllimit të gjashtë të librit të tij “El-Ihkam” ia kushton çështjes rreth shpalljes së pavlefshme (të pasimit).

Po ashtu, Ibni Kajimi në librin “*Tēlamul Mukiijnē*”, 2/187-260, i përmend tetëdhjetë e një mënyra për t’iu kundërpërgjigjur mendimit të pasimit. Kjo duke e tërhequr vërejtjen në atë që e kam përmendur se si e kanë kritikuar pasimin e katër medhhebeve dhe mbrojtjen prej asaj që është thënë për të pasur qëndrim të qartë në çështjen e pasimit. As nuk është e lejuar në mënyrën absolute, ashtu siç nuk duhet lënë në harresë ajo çka ndodhë në praktikë. Njeriu i rëndomtë për shkak të aftësisë së kufizuar për

studim dhe ixhtihadë nuk ka alternative tjetër përpos që të pasoje dietarin, pra ai patjetër se duhet të pasoj. Përderisa sa i përket dijetarëve, edhe poqëse nuk janë kompetent për ixhtihadë, ata nuk janë të detyruar që të pasojnë në përgjithësi vetëm një medhheb të çdo dispozite prej dispozitave të fikhut por duhet të pranojnë atë që rezulton argumenti i drejtë, e jo të mos i pranojnë të tjerët, duke mos ndier keqardhje për asgjë apo duke mos qenë fanatik në një medhheb prej medhhebeve. Ata duhet kërkuar vetëm të vërtetën. E vërteta është një dhe e pandryshueshme, dhe siç e ka përmend Ibn Kajim el Xhevziju: **Feja e Allahut është një e vetme dhe se sheriatit në tërësi kthehet në një mendim të degëve të saj edhe nëse ka mendime të shumta**, dhe ashtu siç sqaron Shatibiu në librin “el Muvafekat” që feja edhe në bazat e saj është një.

Këtë çështje më së miri e ka thënë Shejhul Islami Izudin Abdus Selami (“Kavaidul Kubra”): **Është për t’u habitur me pasuesit e dijetarëve, se si ndonjëri i cili i pason ata, qëndron në mendimin e dobët të imamit të tij, dhe nuk shikon për të gjetur diçka çka e largon të dobtën, dhe duke e ditur se është mendim i dobët prapëseprapë pason vetëm atë dhe e anashkalon Kur’anin, sunetin dhe Kijaset e drejta të medhhebeve tjera bile edhe paramendon se si t’i dëbojë dukuritë e Kura’nit dhe të sunetit duke e interpretuar me interpretime të dobëta dhe të plogështa, duke e ngritur lartë të pasuarin e tij.**

Këtë e vërteton atë që e ka thënë Ebu Shame në ligjëratën e tij: (“*El Kitabul Muemelfir Red ilel emril evvel*”) ku thotë:

“Ai i cili mirret me fikh nuk duhet të përkufizohet vetëm me një medhheb të caktuar, por të secilit Imam, dhe për çdo çështje duhet të krijojë bindjen e argumentit i cili është më së aferti me Kur’anin dhe me sunetin, dhe kjo është çështje e thjeshtë për të, nëse veç ai është profesionalizuar me shumicën e diturive të mëparshme (shkencat e ixhtihadit) dhe duhet të çrrënjoset nga fanatizmi dhe nga mendimet kundërthënëse, sepse ato të marrin shumë kohë.”

Tema e tretë: Përmbajtja e pasuesit në një medhheb të caktuar

Siç kanë deklaruar shumica absolute e dijetarëve, rruga e njeriut të rëndomtë dhe e atij i cili nuk është kompetent në ixhtihadë është rruga e pasimit (taklidit) për të kuptuar ligjet e sheriatit, por bie fjala, ai pasues a e ka për detyrë t'i përmbahet një medhhebi të caktuar për çdo ngjarje?

Kjo shumicë absolute e dijetarëve, të cilët janë pajtuar pro pasimit për njeriun e rëndomtë dhe për atë i cili nuk është kompetent për ixhtihadë, kanë dhënë mendime të ndryshme.³⁶

Në bazë të mendimit të disave prej tyre qëndron ajo se, njeriu i rëndomtë nuk vepron në bazë të muxhtehidit në një dispozitë të një ngjarjeje prej ngjarjeve të cilën më parë veçse e ka vepruar, e ai nuk duhet të kthehet prapa dhe të mos e pasoj (mendimin e vet) dhe të pasoj tjetrin. Për këtë janë pajtuar Amediu dhe Ibni Haxhibi, dhe sipas mendimit të tjerëve mospajtimi ka të bëjë me çështjen se *më parë ka vepruar*.

- Disa kanë thënë: **Është vaxhib t'i përmbahet një medhhebi të caktuar** sepse ai është i bindur se ai medhheb është i drejtë dhe ai e ka vaxhib t'i përmbahet bindjes së tij.

- Të tjerët kanë thënë: **Nuk është vaxhib pasimi i imamit të caktuar në çdo çështje dhe në çdo ngjarje e cila i paraqitet, por lejohet që të pasoj çdo muxhtehidë të cilin dëshiron, edhe nëse i përmbahet vetëm një medhhebi**, si f.v., medhhebit të Ebu Hanifes, ose Shafiijut, ose të tjerëve, por nuk është e patjetërsueshme që të vazhdoj gjithmonë, por në përgjithësi lejohet që të kaloj prej një medhhebi në një tjetër edhe pas veprimit me njërin prej medhhebeve sepse nuk ka vaxhib pos asaj që e ka bërë vaxhib Allahu dhe i dërguari i Tij, sepse kështu ai do të bënte detyrim diçka që nuk e ka bërë Allahu dhe i dërguari i Tij, pasi Allahu nuk e ka bërë detyrim përmbajtjen në një medhheb të caktuar dhe përmbajtja në një medhheb nuk nënkupton betim (premtim) i cili duhet të zbatohet, por Allahu e ka bërë detyrim pasimin e dijetarëve pa e specifikuar njërin prej tjetrit. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

فَاسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

“Ju pyetni pra dijetarët nëse ju nuk dini.” (En-Nahl : 43)

Dhe se ata të cilët kanë kërkuar fetva në kohën e sehaveve dhe tabiinëve nuk kanë qenë të detyruar të i përmbahen një medhhebi të caktuar, por i bënë pyetje atyre të cilët ishin të përshtatshëm për ta, por pa u përkufizuar në njërin ndaj tjetrit dhe askush nuk e ka urreyer një gjë të tillë dhe ky ishte ixhmaë prej tyre, pa u bërë obligim pasimi në ndonjë imam, ose pasimin në ndonjë medhheb të caktuar në çdo çështje.

Po ashtu, mendimi për t’ju përmbajtur vetëm një medhhebi shpie në lodhje dhe vështirësi, edhe pse medhhebet janë vlerë, begati dhe mëshirë për umetin. Ky është mendimi prioritar i dijetarëve.³⁷

- Disa prej tyre, si f.v., Amediu dhe Kemal bin Hemami, e bëjnë dallimin dhe thonë: “Të vepruarit me atë çka janë detyrim disa çështje në një medhheb të caktuar, nuk lejohet pasimi i tjetrit në po ato çështje dhe nëse nuk veprojnë në disa çështje tjera, lejohet pasimi i tjetrit në po ato çështje sepse në ligj nuk ekziston diçka që e bën obligim pasimin dhe përmbajtjen e vetëm të një medhhebi, por ligji e bën obligim pasimin e dijetarëve pa e specifikuar një dijetar prej tjetrit, siç edhe e sqaruar më herët.”

A lejohet (pasuesi) t'i përmbahet medhhebit, i cili medhheb është pjesërisht në kundërshtim me imamin e tij?

Nëse një njeri i rëndomtë i përmbahet një medhhebi të caktuar, dijetarët kanë mospajtim tjetër, e ajo është se, a i lejohet atij që në disa çështje t'ia kthej shpinën imamit të tij dhe të marr mendimin e tjetrit, me fjalë tjera, *a e ka detyrim vazhdimësinë e atij medhhebi dhe të mos kaloj te një medhheb tjetër në një çështje prej çështjeve?*

- Thuhet: Absolutisht lejohet.

- Thuhet: Absolutisht nuk lejohet.

- Thuhet: Duhet bërë dallimin, nëse veçse e ka vepruar (me një medhheb) atë çështje, nuk lejohet të kaloj, e nëse nuk ka vepruar, lejohet.

- Thuhet: Duhet bërë dallimin, nëse një ngjarje ka ndodhur dhe e ka pasuar medhhebin në atë ngjarje, atëherë nuk lejohet, nëse jo (nuk ka ndodhur ajo ngjarje), atëherë lejohet.

- Ka edhe mendime tjera.³⁸

Mendimi më i saktë është mendimi se, lejohet që të kundërshtohet imami (medhhebi) pjesërisht dhe të merret mendimi i (medhhebeve) tjerëve sepse përmbajtja i vetëm një medhhebi nuk është detyrim, sepse nuk ka detyrim (vaxhib) pos atë që e ka bërë detyrim (vaxhib) Allahu dhe i dërguari i Tij, dhe Allahu dhe i dërguari i Tij nuk e kanë bërë detyrim (vaxhib) askënd që t'i përmbahet tërësisht medhhebit të një imami, dhe siç thotë autori i librit “Muslimu Thubut” kjo tregon se, *detyrimi për pasim (taklidë) është ligjësim i ri.*

Pasimi i një medhhebi tjetër përpos njërit prej katër medhhebeve

Pasi që kam favorizuar mendimin për të mos iu përmbajtur vetëm një medhhebi të caktuar, atëherë çështja a ka të bëjë për përmbajtjen e vetëm njërit prej katër medhhebeve apo lejohet që të pasohen edhe medhhebe tjera si f.v. medhhebi i quajtur *medhhebi i sehaveve*, ose medhhebi dhahirijë, ose medhhebi i Lejthit, ose medhhebi i Evzaijut, ose medhhebi i Ibni Xherir et-Taberiut, ose i ndonjë tjetri.

Për këtë, dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme:³⁹

1. Disa prej dijetarëve të mëvonshëm kanë thënë: **“Nuk lejohet pasimi përpos njërit prej muxhtehidëve të katër medhhebeve** sepse medhhebet tjera nuk janë themeluar dhe nuk janë saktësuar si medhhebe, gjë që e bën që pasuesi t’i nënshtrohet gabimit dhe interpretimit të gabuar, e që e kundërta është me katër medhhebet, ato janë themeluar, janë saktësuar dhe janë bërë të njohura për shkak të themelimit të tyre dhe të përkujdesjes nga ana e studentëve të tyre për t’i sqaruar imtësitë e tyre, për të bërë specifikimin e të përgjithshmes së tyre dhe përcaktimin e të papërcaktuarës së tyre, e kjo bën që në ta njeriu të ndjej siguri, për shkak se janë më afër të së vërtetës dhe më larg nga e pavërteta.

Imam i dy Haremeve thotë: **“Analistët janë pajtuar se njerëzit e rëndomtë nuk duhet që të ndërliken me medhheb të sehaveve r.a., por duhet t’i përmbahen medhhebeve të umetit, të cilat kanë hulumtuar,** kanë hapur dyert, janë themeluar dhe e kanë treguar vendin e çështjeve, sepse kanë sqaruar rrugët e të hulumtuarit, i kanë përgatitur çështjet, i kanë analizuar dhe i kanë koleksionuar.”

Ibn Salahi ka thënë: **“Përcaktohet pasimi i katër medhhebeve dhe jo i tjerëve** sepse ato janë përhapur dhe janë precizuar të paprecizuara e tyre, janë specifikuar të përgjithshmet prej tyre, janë shpërndarë çështjet dytësore prej tyre, e që e kundërta është te medhhebet tjera.”

2. **Disa dijetarë e kanë lejuar që të pasohet ndonjë tjetër pos katër medhhebeve në çështje që nuk kanë të bëjnë me fetvanë** dhe thonë: “Është i lejuar pasimi i tjerëve përpos katër medhhebeve në çështje të cilat nuk kanë të bëjnë me fetvanë, e kjo vetëm si lehtësim.”

Profesori Sulejman el Buxhejriju Shafii, ka thënë: “Në fetva dhe në gjykime, nuk lejohet pasimi në ndokënd tjetër përpos në katër medhhebet.”

3. El Iz bin Abdus-Selame ka thënë: **“Çështja e përqendrimit të medhhebit kur të pasohet dhe kur të peshon saktësia në atë medhheb dhe përderisa ai është përcaktuar në një medhheb, i lejohet ta pasoj edhe nëse autor i atij medhhebi nuk është njëri prej katër medhhebeve.”**

Në fakt, nëse shikohet se ku bazohet mendimi i parë, shihet se mbështetet në refuzimin e lejimit të pasimit të atij i cili konfirmohet dhe jep mendim, atëherë e drejtë është pasimi i ndonjërit përpos katër medhhebeve nëse vërtetohet autorësia. Për këtë arsye, mendimi më i drejtë është mendimi i El Iz Abdus-Selamit, sepse nuk ka argument se duhet përmbajtur vetëm në njërin prej dijetarëve të katër medhhebeve r.a. siç edhe e sqaruam, ata dhe të tjerët janë të njëjtë.

Irakiju ka thënë: “A është aprovuar ixhmai se ai i cili e pranon fenë islame ai mund ta pasojë cilin do prej dijetarëve pa përkufizim?! Janë pajtuar sehabet r.a. se kush kërkon përgjigje prej Ebu Bekrit dhe Umerit, dhe i pason ata, ai mund të kërkojë përgjigje prej Ebu Hurejres, prej Muadh Ibni Xhebelit dhe të tjerëve, dhe vepron me mendimet e tyre pa përjashtim. Kush pretendon të mos i pranojë këto dy aprovime të ixhmail, ai duhet të sjell argument.”⁴⁰

4. Ka edhe një mendim të njohur prej disa dijetarëve bashkëkohorë, e ajo me pak fjalë është: **“Njeriu i rëndomtë nuk ka të bëjë me çështjen e pasimit të njërit prej katër medhhebeve sepse medhhebi i tij është medhhebi i muftiut të tij,** por kjo ka të bëjë me atë i cili është kompetent të bëjë krahasimin e mendimeve. Këta, kur të arrijnë përfitimin e njërit mendim prej katër imamëve të medhhebeve, e paraqesin te argumentet e sheriatit, dhe kur të hasin një argument prej Kur’anit dhe suneteve të sakta më të fuqishme se argumentet e të tjerëve, atëherë orientohen në atë drejtim dhe

favorizojnë në bazë të gjykimit të rregullave përpiluese, mjeteve dhe çështjeve favorizuese të parapara me shkencën e usuli fikhut.”⁴¹

Tema e katërt: Përzierja (TELFIKI) e medhhebeve dhe ndjekja e lehtësimeve

Në botën islame ideja e pasimit (taklidi) apo me fjalë tjera përzierja e medhhebeve të shumica e dijetarëve është përhapur pas përfundimit të shek. të dhjetë pasi të mëhershmit kanë kushtëzuar që, në pasimin e medhhebit tjetër të mos vjen çështja e përzierjes së medhhebeve.

Ibni Haxheri dhe të tjerët kanë thënë: **“Kush është *për (pro)* përzierje të medhhebeve, ai është në kundërshtim me ixhmain.”**

Sipas mendimit tim, të gjithë këtyre u mungojnë faktet dhe argumentet për atë që thonë.

Po ashtu, ata kanë kushtëzuar që për lejinin e pasimit të mos i pasojnë lehtësimet të cilat qojnë deri te devijimi i qartë i vijave të trasha të islamit, kështu që, patjetër duhet të flasim për përzierjen dhe ndjekjen e lehtësimeve.

Përzierja (telfiki) – është të vepruarit e atij veprimi për të cilin veprim nuk thotë muxhtehidi. Kuptimi i saj është që të veprohet në atë mënyrë që pasuesi të pason shumë medhhebe dhe në një çështje të pranohen kushtet apo pjesa e saj nga dy mendime e më shumë për të arritur te e vërteta e bashkdyzuar të cilën nuk e ka ligjësuar askush,⁴² pa marrë parasysh a është imami të cilit i përket apo imami tek i cili ka kaluar. Secili prej tyre ka deklaruar pavlefshmërinë e atij realiteti e cila realizohet në adhurim.

Shembull:

Një person i cili pason medhhebin Shafii dhe i mjafton që gjatë abdesit të lëmoj vetëm një pjesë të vogël të kokës, e pastaj e pason Ebu Hanifen ose Malikun në çështjen e mosprishjes së abdesit me rastin e prekjes së femrës

dhe pastaj falet. Falja në këtë mënyrë me këtë abdes nuk është thënë nga asnjëri prej këtyre dijetarëve.

Shafiiu thotë se namazi është i pavlefshëm për shkak të prekjes së femrës.

Ebu Hanife thotë se namazi është i pavlefshëm për shkak se nuk e ka lëmuar një të katërtën e kokës.

Maliku nuk thotë se nuk i pranohet namazi sepse nuk e ka lëmuar kokën në tërësi ose për shkak të pjesëve të abdesit, e të ngjashme.⁴³

Prej shembujve të përzierjes, në statusin personal është që, njeriu martohet me një grua pa prezencën e kujdestarit të saj dhe pa mehr e dëshmitarë, duke e pasuar secilin medhheb në atë që ai nuk e thotë, mirëpo ai me përzierje dëshiron t'i ikë të ndaluarës. Kjo nuk lejohet, siç edhe do ta sqaroj sepse është në kundërshtim me ixhmain. Këtë formë nuk e ka lejuar askush.⁴⁴

Shembull tjetër: Nëse njeriu e shkurorëzon tri herë bashkëshorten e tij, pastaj ajo martohet me një djalë nëntëvjeçar që (ta shkurorëzoj) t'i lejohet gruaja për rikurorëzim duke e pasuar medhhebin Shafii për të qenë kurorëzimi i vlefshëm. Pastaj djali (nëntëvjeçar) e shkurorëzon atë (gruan) për të qenë shkurorëzimi i vlefshëm dhe e kalon afatin e pritjes (iddetit) duke e pasuar imam Ahmedin dhe kështu i lejohet akti i kurorëzimit me burrin e saj paraprak.⁴⁵

Siç thotë prof. Alij el-Exhheriju, dijetar Shafii, vërehet se rastet e ngjashme janë të ndaluara në kohën e sodit. Dhe nuk lejohet të veprohet në këtë mënyrë në këtë çështje sepse te Shafii është kushtëzohet që fëmija i cili martohet të ketë babën ose gjyshin e tij, dhe që të jetë i drejtë dhe të jetë në dobi të fëmijës, dhe që gruaja e cila martohet me fëmijën duhet ta ketë kujdestarin e saj të drejtë dhe dy dëshmitarë të drejtë. Nëse mungojnë këto kushte nuk lejohet *tehlili* (lejimi martesor pas ndalesës së kushtëzuar) sepse kurorëzimi është i pavlefshëm.

Prej shembujve tjerë sjellim edhe këtë: Nëse një person e merr një vend të vakëfit me koncesion për nëntëdhjetë e më shumë vite, pa e parë atë parcelë.

- Për afatin kohor e pason Shafiijun dhe Ahmedin,
- Për mos shikimin e parcelës e pason Ebu Hanifen sepse tek ai lejohet koncesioni pa e parë tokën.

Fusha e përzierjes (telfikit)

Çështja e telfikit është e njëjtë sikurse fusha e pasimit (taklidit), siç edhe e kemi sqaruar më parë, pra fusha e saj shtrihet në çështjet jo të sigurtat të ixhtihadit. Përderisa ajo çka njihet si domosdoshmëri në fe, të cilat janë të ndërlidhura me ligjin e sheriatit, ato janë për të cilat janë pajtuar dijetarët e umetit, mohuesi i atyre ligjeve konsiderohet pabesimtar, nuk lejohet pasimi (taklidi), e mos të flasim për përzierjen (telfikin) e medhhebeve. Nuk lejohet përzierja e cila shpie në veprimin e të ndaluarës, si f.v., në pirje të alkoolit, në prostitucion, e të ngjashme.

Ligjësimi

Argumentimi i atyre të cilët e ndalojnë përzierjen (telfikin) është rezultat të cilin e kanë thënë dijetarët e usulit në mënyrë unanime, e kjo për të ndaluar shpikjen e mendimit të tretë atëherë kur dijetarët ndahen në dy grupe në gjykimin e një çështjeje.

Te shumica absolute e dijetarëve nuk lejohet mendimi i tretë, për atë çështje që dijetarët janë pajtuar, si f.v., ideti i gruas së cilës i ka vdekur burri kur ajo është shtatzënë, për këtë çështje ekzistojnë dy mendime:

- deri sa të lind,
- maksimumi i shtatzënisë.
- nuk lejohet të paraqitet ndonjë individ me mendimin se ideti i saj duhet të jetë vetëm me muaj.⁴⁶

Pavlefshmërinë e pretendimit se telfiki (përzierja) është i pavlefshëm e replikojmë në dy mënyra:

- **Mënyra e ndalimit dhe e mohimit, dhe**
- **Mënyra e vërtetimit të kundërt.**⁴⁷

Sa i përket ndalimit dhe mohimit,⁴⁸ çështja është e qartë, telfiki është i ndërtuar mbi idenë e taklidit-pasimit, të cilin e kanë vendosur dijetarët e mëvonshëm në kohën e programimit, e ajo është se, telfiki nuk është i njohur në kohën e të parëve, e as në kohën e pejgamberit s.a.v.s. dhe as në kohën e sehaveve dhe as në kohën e imamëve të medhhebeve e as të studentëve të tyre:

- Sa i përket kohës së pejgamberit s.a.v.s. absolutisht nuk ka alternativë të telfikit sepse ka qenë koha e zbritjes së shpalljes, në të cilën nuk ka pas ixhtihadë.

- Sa i përket epokës së sehaveve dhe tabiinëve, po ashtu nuk është i njohur, sepse nuk dihet se ka ndodhur prej tyre, por secili pyeste tjetrin çka do që dëshironte dhe tjetri jepte fetva pa i obliguar me mendimin e tjetrit, ose të jetë i përkufizuar në veprimin e mendimit të tjetrit, duke i pasur parasysh sqarimet e shumta e të ndryshme të tyre.

- Po ashtu, imamët e katër medhhebeve dhe të tjerëve të cilët bënë ixhtihadë, nuk na është raportuar se ndonjëri ka ndaluar të veprohet me medhhebin e tjetrit, por secili prej tyre mbështetej pas tjetrit, pasi që e dinte se mendimi kundër përzierjes ishte rreth ixhtihadit i cili ishte jo i sigurt. Kjo dëshmon se çdonjëri i cili pyeste, pranonte mendimet e dijetarëve në dy e më shumë çështje. Mendimet e dy muftive të njëri-tjetrit ishin pjesë e këtij pyetësi por nuk kishin këtë qëllim të cilin jemi duke e shpjeguar, sikurse ndërhyrja e njërit dialekt në tjetrin në gjuhën arabe.

Më shumë se kaq... Mendimi i ndalimit të telfikit (përzierjes) do të na e përçonte mesazhin e moslejimit të taklidit (pasimit) e cila parimisht për të rëndomtë është vaxhib. Edhe pse në të shumtën e rasteve *taklidi* nuk është *telfik* dhe është në kundërshtim me parimin e atij i cili thotë: ***Mendimet e ndryshme janë mëshirë për umetin dhe është në kundërshtim me bazën në***

të cilën është ndërtuar sheriatu islam, e ajo është toleranca dhe lehtësimi dhe largimi i lodhjes dhe vështirësive.

Përderisa, sa i përket mënyrës së vërtetimit të së kundërtës, pas presupozimit të vlefshmërisë së atyre të cilët thonë se ndalohet telfiki dhe pas pranimit të mendimit të tyre, del në shesh ajo të cilën dijetarët e kanë konstatuar se, nuk duhet të përmbahet vetëm një medhheb i caktuar, dhe se telfiki lejohet, se përndryshe adhurimet e njerëzve të rëndomtë do të ishin të pavlefshme, sepse vështirë se mund të haset njeri i rëndomtë i cili i kryen adhurimet në përputhshmëri me një medhheb të caktuar. Përderisa, kushtëzimi i tyre në domosdoshmërinë e shikimit të kundërshtimit ndërmjet dijetarëve, nëse ndonjëri pason një medhheb, ose anashkalimin e një medhhebi për një çështje, kjo do të ishte e vështirë, pa marrë parasysh në adhurime apo në veprim të raporteve reciproke. Kjo do të ishte në kundërshtim me tolerancën e sheriatit, lehtësimin të asaj dhe orientimit të saj në dobi të njerëzve.

Shembull: Nëse një njeri merr abdes dhe lëmon një pjesë shumë të vogël,

- duke e pasuar medhhebin Shafii, abdesi i tij është i vlefshëm dhe
- nëse pas kësaj e prek organin intim, duke e pasuar medhhebin Hanefijë namazi i tij është i vlefshëm, pra namazi i këtij pasuesi është i vlefshëm, për këtë janë pajtuar dijetarët, sepse prekja e organit intim, te Hanefijtë, nuk e prishë abdesin.

Dhe nëse një person e pason atë në mosprishje e cila është e vlefshme te Shafiijtë, abdesi vazhdon të jetë i vlefshëm në bazë të kushteve të Ebu Hanifes.

Këto dy çështje janë të ndara nga njëra tjetra, sepse:

- abdesi është i plotë në bazë të Shafiiut dhe,
- pas prekjes së organit intim vazhdon të jetë i vlefshëm në bazë të Ebu Hanifes, e,
- pasimi i Ebu Hanifes është bërë vetëm për të vazhduar vlefshmëria dhe jo prej fillimit të saj (abdesit).

Përderisa, sa i përket pretendimit të disa Hanefijëve⁴⁹ se ekziston ixhmai në ndalimin e telfikit, kjo ka të bëjë me pajtueshmërinë e pjesëtarëve të vet medhhebt, ose vetëm se kanë dëgjuar, ose është mendim me mëdyshje, sepse po të ishte çështje për të cilën dijetarët janë pajtuar atëherë kjo çështje do të ishte regjistruar si tekst edhe nga medhhebet tjera, sepse ixhmai patjetër se duhet të jetë i hapur, i paraqitur deklarativisht nga kompetentët duke e nënvizuar dhe në ixhmaë nuk mjafton vetëm heshtja dhe mundësia e themelimit të saj.

Argumenti më tregues për mosthemelimin e ixhmailt është se shumë dijetarë të mëvonshëm e kanë kundërshtuar haptazi.⁵⁰

Ibn Hemami në komentin e tij dhe duke u pasuar nga studenti i tij Ibn Emijr el Haxh thotë: **“Pasuesi ka të drejtë të pasoj cilin do që dëshiron.** Nëse njeriu i rëndomtë merr prej secilit muxhtehidë, kjo për të është më e lehtë. Nuk e di se ka diçka që e pengon këtë, si në aspektin logjik, ashtu edhe ligjor. Natyrshmëri e njeriut është që ai prej muxhtehidit i cili e konkludon çështjen me ixhtihadin e tij, të pasoj atë çka është më e lehtë për të. Nuk di që ndonjë ligj prej ligjeve nuk e lejon këtë. Pejgamberi s.a.v.s. e dëshironte atë çka është më e lehta për umetin e tij.”

Përderisa, sa i përket dy imamëve, këta janë pajtuar për pavlefshmërinë e telfikit (përzierjes). Ky mendim nuk fuqizohet me ndonjë argument sepse pasuesi nuk pason në secilën prej tyre në veprimtarinë e tij të përgjithshme por e pason secilin prej tyre për një çështje të caktuar, për të cilën nuk e pason tjetrin. Nuk ka të keqe në këtë. E gjithë veprimtaria nuk obligon të shikohet vetëm nga ky këndvështrim, as në ixhtihadë dhe as në pasim, por është shpikje (nga vetja) e ligjit sheriativ e atij i cili nuk është kompetent që ta thotë. Ligjërues për të është Allahu i Lartmadhëruar dhe çdo ligjërime e ka edhe efektin juridik të tij.

Në librin **“Et-Tenkijh”** të Ibni Abidijnit, është si në vijim: “Ajo çka buron prej mendjes së muftisë është çka tregon për lejimin e dispozitës së dyanshme”, dhe se profesori Tususiju shkon në drejtimin e lejimit.

Po ashtu dijetari Ebu Suudi në fetvatë e tij e ka lejuar.

Ibni Nexhimi në librin e tij **“Bej’ul Vakfi bi gubnil fahish”** ka treguar vendimin e tij përfundimtar për lejimin e telfikit (përzierjes së medhhebeve).

Nga fetvatë e Bezazijut është raportuar për lejimin.

Ibn Urfete el Malikiju në librin “Hashijete ale-sherhul-kebîr” ka vërtetuar pro *lejimit*.

Profesori el-Adeviju dhe të tjerët e kanë lejuar.⁵²

Shumica absolute e dijetarëve, prej tyre disa Shafijë, shkojnë në atë drejtim se raportimi për ixhmain në lidhje me këtë çështje është rast i izoluar dhe me pretendimin për ixhmaë të tillë nuk është obligim të veprohet, siç e kemi sqaruar në temën e ixhmainit.

Duke pasur parasysh se pretendimi për ixhmain është i papranuar sepse është treguar saktësisht se ka pasur mospajtime, si f.v., Ferhametul Emirë dhe Fadil Bejxhuri.

Shefshaveniju, sa i përket çështjes për veprimin me dy e më shumë medhhebe thotë: ***Dijetarët e usulit kanë dhënë mendime të ndryshme në lidhje me këtë çështje. E vërteta për këtë këndvështrim është lejimi.***

Përfundim: Pa dyshim se Allahu dëshiron lehtësim dhe jo vështirësim dhe mendimi për lejimin e telfikit është prej natyrës së lehtësimit në mes njerëzve:

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَمَا جَعَلَ عَلَيْكُمْ فِي الدِّينِ مِنْ حَرَجٍ

“...dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi.” (El Haxh : 78)

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

يُرِيدُ اللَّهُ أَنْ يُخَفِّفَ عَنْكُمْ ۖ وَخُلِقَ الْإِنْسَانُ ضَعِيفًا

“All-llahu dëshiron t’ju lehtësoj, e megjithatë njeriu është i paaftë.” (En-Nisa : 28)

Zoti i Lartmadhëruar thotë: يُرِيدُ اللَّهُ بِكُمُ الْيُسْرَ:

“All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju.” (El Bekare : 185)

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Jam dërguar për tolerancë të sinqertë.”**

Përzierja (telfiki) e ndaluar

Nuk themi se përzierja (telfiki) lejohet në mënyrë të pakufizuar, pasi ajo është e kushtëzuar në sferë të caktuar. Prej përzierjes, ka çka është e pavlefshme vetvetiu, si f.v., nëse përzierja shpie në lejimin e të **ndaluarave**, shembull, alkoolin, prostitucionin, e të ngjashme.

Ka përzierje e cila ndalohet, por jo në vetvete, por që i paraqitet element prej elementeve dhe është tri llojesh:⁵³

E para: Qëllimisht, pason vetëm lehtësimet, si f.v., njeriu merr nga secili medhheb atë çka është më e lehta për të, pa nevojë dhe pa domosdoshmëri. Kjo është e ndaluar, e kjo ndalesë vjen për të parandaluar të keqen, dhe për të mos lejuar ikjen nga obligimet e shariatit.

Gazaliu thotë: **“Askush të mos merr nga medhhebi tjetër si pasojë e apetiteve.** Njeriu i rëndomtë nuk ka të drejtë t’i mohoj mendimet e medhhebeve në të gjitha çështjet të cilat janë të mira për të dhe të zgjerohet...”⁵⁴ Brenda këtij lloji kategorizohet se më parë duhet t’i pasoj lehtësitë dhe jo për t’i mohuar dhe për t’i marrë mendimet më të dobëta të secilit medhheb, duke e pasuar epshin dhe dëshirat.

E dyta: Telfiki i cili nënkupton kundërshtimin e dispozitës së qeveritarit, sepse dispozita e tij i jep fund mospajttimeve për të mos lejuar anarki.

E treta: Telfiki i cili nënkupton kthimin nga veprimi i pasimit, ose për një çështje për të cilën çështje janë pajtuar që të pasohet.

Shembull i rastit të parë: Ajo çka është raportuar nga fetvatë hindije: Nëse fakihu i thotë gruas së tij, ti je e shkurorëzuar përgjithmonë, e me këtë ai e ka ndërmend që ai shkurorëzim të jetë i trihershëm dhe fjala e tij shikohet ashtu siç e kanë kuptuar ata dy dhe ai ka vendosur që t’i ndalohet atij, e pas kësaj ai ka dashur që ai shkurorëzim të jetë rikthyes. Merret për bazë mendimi i tij i parë dhe siç e ka pasur qëllimin në fillim dhe nuk

lejohet t'i kthehet gruaja e tij duke u mbështetur në mendimin e tij të dytë të mëvonshëm.

Po ashtu, nëse në fillim ka pasur për qëllim shkurorëzimin me të drejtë kthimi, e pastaj e mendon ta ketë thënë për shkurorëzim të trihershëm. Mirëpo duhet pasur parasysh se kthimi pas veprimit nuk lejohet, nëse ka pasur të bëjë me të njëjtin rast, e jo të një rasti tjetër të ngjashëm, argument për këtë është çka shkruhet në librin “Fetava Hindije”, se: Kur me fjalën e tij *je e shkurorëzuar përgjithmonë*, ka pasur për qëllim shkurorëzimin me të drejtë kthimi, ai e kthen atë. Pastaj kur i thotë gruas tjetër, *ti je e shkurorëzuar përgjithmonë*, e pas një kohe thotë se me këtë e ka pasur për qëllim shkurorëzimin e trihershëm, atëherë me këtë thënie i ndalohej edhe gruaja e rastit të parë. Kështu e ka sqaruar Sebekiju dhe e kanë pasuar shumë dijetarë të tjerë.

Vërehet se kthimi (heqja dorë) nga pasimi pas praktikimit është i pavlefshëm, siç kanë deklaruar dijetarët e usulit është i kushtëzuar në atë çka ka mbetur prej gjurmëve të veprimit të parë, gjurmë të cilat shpijnë te veprimi i përzierjes (telfikit) për të cilin nuk pajtohen të gjithë muxhtehidët.

Shembulli i rastit të dytë: Nëse një njeri e pason Ebu Hanifen në kurorëzim pa kujdestar, atëherë nënkuptohet se akti i kurorëzimit ka ndodhur dhe është i vlefshëm dhe është çështje që unanimisht (ixhmaë) nënkupton kurorëzimin. Nëse e shkurorëzon tri herë, pastaj për të mos ndodhur shkurorëzimi dëshiron ta pasoj Shafiiun, nga natyra e kurorëzimit pa kujdestar⁵⁵ nuk e ka këtë drejtë sepse është kthyer nga pasimi në çështje për të cilën unanimisht ka qenë i domosdoshëm.⁵⁶

Unë them se ky mendim për këtë çështje është i drejtë sepse përkujdesja në çështje nderi duhet të jetë më i madh se kujdesi në çështje tjera sepse do të rezultonte që raportet e mëhershme të tyre të kishin qenë raporte (sjellje) të ndaluara dhe se fëmijët e tyre do të kishin qenë fëmijë nga prostitucioni, kështu që duhet të mbyllen të gjitha dyert (shtigjet) të cilat shpijnë te këto imagjinata për çdo çështje serioze, si p.sh., në kurorëzim, ose në çdo çështje që shpie në tallje të fesë ose në dëmtim të njerëzve ose në shkaktim të çrregullimit në tokë.

Sa i përket çështjeve të adhurimit dhe obligimeve, për të cilat Allahu nuk ka bërë vështirësi për robërit e tij, përzjerja (telfiki) nuk është i ndaluar, edhe poqëse rezulton kthim nga veprimi i mëparshëm, ose të një çështje për të cilën ka unanimitet se është detyrshme, përderisa nuk shpie në shkëputjen e lidhjes së obligimeve, ose në asgjësimin e urtësisë së ligjit dhe pasimit të epshit të cilat e ndryshojnë sheriatin ose që tregon objektivitetin e saj.

Dispozita e telfikit në obligimet e sheriatit

Më herët e kuptuam se sfera e telfikit ka të bëjë me çështjet dytësore sheriateve të ixhtihadit, pra me ato të cilat janë jo të sigurta, që do të thotë se, dijetarët nuk janë pajtuar (për ato çështje), përderisa në akaid dhe në çështje të besimit, në ahlak dhe për çdo çështje të domosdoshme në fe, nuk hyn brenda kornizës së përzjerjes (telfikit) sepse dijetarët unanimisht nuk e lejojnë pasimin në këto çështje, madje këto nuk janë as çështje të ixhtihadit, për të cilat do të kishte pasur hapësirë për *mospajtime (diversitet)* në të cilat (mospajtime) ka bazë *taklidi dhe telfiki*.

Përderisa telfiki vjen në çështje dytësore, duhet të sqarojmë dispozitën në to.

Çështjet dytësore të sheriatit ndahen në tri lloje:⁵⁷

E para: Ajo çka në sheriatë është ndërtuar mbi bazën e tolerancës, të cilat ndryshojnë me ndryshimin e rrethanave të njerëzve.

E dyta: Ajo çka është ndërtuar mbi bazën e devotshmërisë së vullnetshme.

E treta: Ajo çka strukturimi i saj është për interesin dhe lumturinë e njerëzve.

Sa i përket llojit të parë: Adhurimet e pastra. Për nevojë, në këtë lloj lejohet telfiki sepse forma e praktikimit të ibadeteve të urdhëruara nga Allahu kanë të bëjnë me urdhrin e Allahut të Lartmadhëruar, të cilat nuk janë shkaktim vështirësie, prandaj këto adhurime nuk duhet të vështirësohen sepse këmbëngulësia e tepërt shpie në shkatërrim.

Përderisa, sa i përket adhurimeve të natyrës materiale, ka prej tyre të cilat duhet shtrënguar, kjo si rezervë nga frika për t'i mos humbur të drejtat e të varfërve, andaj zekatdhënësi nuk ka të drejtë që të marrë vetëm mendimin më të dobët (lehtë) ose që të bëjë telfikë (kombinim) nga secili medhheb, dhe t'i marrë ato që janë më të lehta, e kështu t'ua humb të drejtat të varfërve, prandaj muftiu, në këtë lloj, duhet të jap fetva atë çka është më e përshtatshme dhe më harmonike, duke e pasur në konsideratë gjendjen e pyetësit dhe natyrshmërinë e tij, pra atë se a është i vendosur apo jo.

Sa i përket llojit të dytë, ka të bëjë me ndalesat, e këto janë të ndërtuara mbi bazën rezerve, dhe për të pranuar çka është më e moralshme,⁵⁸ në bazë të mundësive, sa më mirë të jetë e mundur. Në këto nuk lejohet tolerancë ose telfikë (kombinim), përpos në rast të domosdoshmërisë ligjore sepse domosdoshmëritë lejojnë të ndaluarat. Në hadithë thuhet: **“Çka u është ndaluar, largohuni, çka u kam urdhëruar (për të vepruar), veproni në bazë të mundësive.”**⁵⁹ Urdhri është i përcaktuar në bazë të mundësisë. Ndalesa është bërë për të larguar dëmin.

Në ndalesa nuk rezulton formula e telfikit nga shkaku se ato janë të ndërtuara mbi bazën e devotshmërisë dhe të rezervës, të bazuar në hadithin e Ibni Mes'udit: **“Çdo herë kur të bashkohet hallalli me haramin, dominon harami mbi haramin.”**⁶⁰

Po ashtu edhe nga hadithi tjetër: **“Lëre të dyshimtën për atë çka nuk është e dyshimtë.”**⁶¹

Përderisa, sa i përket ndalesave të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e robërve, në to nuk lejohet telfiki (kombinimi) sepse është lloj imagjinate,

është për t'i shkelur të drejtat e njerëzve dhe për keqpërdorimin dhe dëmtimin e njerëzve.

Sa i përket llojit të tretë, janë veprimet reciproke ndërnjerëzore dhe dënimet penale, dhe donacionet duke filluar nga një e dhjeta, një e njëzeta në xehe, haraxhi, në kurorëzime, në kurorëzimet të cilat rezultojnë në ndarje e baza e tyre është lumturia bashkëshortore dhe lumturia e familjes. Sigurimi i saj bëhet duke mbajtur lidhshmërinë e familjes dhe duke pasur mirësjellje brenda familjare, ashtu siç e konstaton Kur'ani:

فَأَمْسَاكُ بِمَعْرُوفٍ أَوْ تَسْرِيحُ بِإِحْسَانٍ

“e (pastaj) ose jetë e njerëzishme (bashkëshortore) ose shkurorëzim me mirëkuptim..” (El Bekare : 229)

Çdo gjë e cila mbështetet në këtë bazë, veprohet me atë çështje edhe pse në disa çështje shpie deri te telfiki (përzierja), vetëm se telfiki nuk duhet të merret si mjet për t'u tallur me njerëzit në çështje të kurorëzimit dhe shkurorëzimit, por duhet shikuar rregulli i sheriatit **“Esenciale në jetën bashkëshortore është sigurimi nga të ndaluarat.”**⁶² Në këtë mënyrë bëhet sigurimi i të drejtave të grave dhe pasardhësve, andaj në këtë rast telfiki nuk lejohet.

Përderisa, sa i përket raporteve ndërnjerëzore dhe donacionet materiale, dënimet e përcaktuara penale, sigurimi i jetëve, obligimet e tjera të ngjashme duke e pasur parasysh interesin e njerëzve dhe çështjet e jetës, duhet të merret nga secili medhheb ajo çka është më e mira e mundshme dhe ajo e cila e siguron interesin e njerëzve dhe lumturinë e tyre, edhe nëse duhet të bëhet kombinimi (telfiki), sepse konsiderohet veprimtari dhe aktivitet i cili shkon pas interesit, i cili edhe është objektivi i Ligjvënësit dhe nga shkaku se interesat e njerëzve ndryshojnë me ndryshimin e kohëve, traditës dhe zhvillimit të jetës dhe kandarit të interesit, siç e kemi mësuar te argumentet e sheriatit për të cilat ka dallime ndërmjet dijetarëve (nuk janë pajtuar). Këtu bën pjesë çdo gjë që siguron pesë bazat e përgjithshme,

sigurimi i jetës, i fesë, i mendjes, i pasardhësve (nderit) dhe pasurisë, dhe sigurimin e çdo interesi i cili është objektiv i sheriatit nga Kur’ani, suneti apo ixhmai, këto janë interesa që korrespondojnë me ligjin dhe që pranohen.

Përfundim – Kandar i lejimit dhe moslejimit të telfikit është, çdo gjë e cila shpie te e kundërta e bazave ligjore, duke u bazuar në politikën dhe urtësinë e tij (sheriatit) rezulton vendimi se është i ndaluar (ky lloj telfiki), posaçërisht në mashtrim, por çdo gjë e cila është krah i bazave të sheriatit dhe çka përputhet me urtësinë dhe politikën e tij për t’u sjell njerëzve lumturi në të dy botët dhe duke ua lehtësuar adhurimet e tyre dhe duke ua siguruar interesat e tyre në veprimtari të ndërsjella është e lejuar dhe e kërkuar.

Sipas mendimit tim, telfiki i lejuar është, atëherë kur është e nevojshme dhe e domosdoshme dhe jo për tallje, ose për të marrë më të lehtën me qëllim, edhe pse nuk ka interes sheriatik, dhe qëllimi i saj është në disa ligje të adhurimeve, dhe marrëdhënie reciproke që ndërlidhen me ixhtihadin dhe nuk janë të prera.

Pasimi i lehtësimeve

Pasimi i lehtësimeve – Nënkupton që për çështjet të cilat i paraqiten, njeriu të merr nga secili medhheb atë që është më e lehtë.

Ne kemi sqaruar kur kemi folur për telfikin e ndaluar se, nuk lejohet që qëllimisht të pasohen vetëm rastet ku ka lehtësime sepse kush i pason ato, sipas disave bën gabim, kurse sipas disa tjerëve nuk bën gabim, për këtë arsye duhet sqaruar boshtin e temës së mospajtimit në mes tyre.⁶³

Një pjesë tjetër, e prej tyre Gazaliu, dhe mendimi më i saktë te Malikijë dhe Hanbelijë, theksojnë: **“Ndalohet pasimi i vetëm lehtësimeve të medhehbe sepse kjo anon në pasimin e epshit të njerëzve.** Ligji ka ardhur për të ndaluar pasimin e epshit. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

فَإِنْ تَنَازَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ

“Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, drejtojuni All-llahut dhe të Dërguarit.” (En-Nisa : 59)

Nga Abdul Berri dhe Ibni Hazmi është raportuar se, unanimisht është thënë se, *njeriu i rëndomtë nuk lejohet të pasojë lehtësimet*, nga shkak se kjo rezulton në moskryerjen e obligimit në çdo çështje e cila ka mendim të kundërt.

Të tjerët, dhe ata janë disa Malikijë si El Karafiju dhe shumica e autorëve Shafijë dhe sipas mendimit prioritar të Hanefijëve, thonë se: Lejohet pasimi i lehtësimeve në medhhebe sepse nuk ekziston bazë ligjore e cila e ndalon atë veprim, pasi që natyrshëm njeriu e pason më të lehtën kur të ketë rrugë dhe i shmanget rrugës së vështirë, madje për këtë tregojnë edhe sunetet shprehimore dhe veprorë të pejgamberit s.a.v.s. sepse **pejgamberi s.a.v.s. çdo herë kur ka qenë në pyetje të zgjidhte në mes të dy çështjeve e zgjidhte më të lehtën**⁶⁴ dhe **“E dëshironte atë që është më e lehta për umetin e tij.”**⁶⁵ Pastaj ka thënë: **“Jam dërguar për tolerancë të pastër.”**⁶⁶ Po ashtu ka thënë: **“Kjo fe është lehtësim, çdo njeri që shtrëngohet në fe, do të jetë i mundur.”**⁶⁷

Shafiiu r.a. ka thënë: ***“Çdo njeri i cili zgjedh në mes të dy çështjeve dhe e zgjedh më të lehtë, ajo është e dashur te Zoti i Lartmadhëruar.”*** Këtë mendim e ka pranuar edhe Kemal bin Hemami në analizën e tij dhe autori i librit “Muslimu Thubut”.

Karafiu ka thënë: “Lejohet pasimi i lehtësimeve, me kusht që të mos veprohet vetëm me mosobligueshmëritë, si f.v., kur e pason imam Malikun në mosprishjen e abdesit me rastin e prekjes pa epsh të femrës dhe e pason imam Shafiiun në mosobligueshmërinë e atyre pjesëve të abdesit (trupit) gjatë abdesit, ose në mos obligueshmërinë e mes’hit të gjithë kokës (gjatë abdesit) sepse atëherë namazi është i pavlefshëm te të dy imamët (Maliku dhe Shafiiu) sepse është i pavlefshëm abdesi te secili prej tyre, siç e kemi sqaruar më herët.

E vërteta është se, kushti të cilin e përmend Shafiiu është: Që pasimi i lehtësimeve të mos rezultojë veprimin që sjell pavlefshmëri te të gjithë të cilët i pason, nuk ka argumentim (në këtë kusht) as tekstual dhe as të ixhmait, por është kusht i mëvonshëm, siç e deklaroi Ibni Hemami në analizën e tij dhe siç thotë autori ***“Tejsirt-Tehrirë”***. Kur një personi i lejohet kundërshtimi i disa çështjeve të muxhtehidëve, për çdo çështje që ata orientohen, atëherë më prioritare do të ishte të kundërshtohet në disa çështje.

Përderisa ajo çka është raportuar nga Ibni Abdul Berri: ***“Unanimisht është thënë se njeriu i rëndomtë nuk lejohet të pasojë lehtësimet.”*** Nuk është vërtetuar saktësisht se e ka thënë atë që është raportuar prej tij. Po edhe po të pranohej, nuk pranohet unanimiteti i dijetarëve për atë mendim sepse për mëkatimin e pasimit të lehtësimeve, nga imam Ahmed i kemi dy raportime:

Në transmetimin e mëkatimit, kadiu Ebu Jeali i jep kuptimin, për jointerpretim dhe jopasim. Ibn Emijr el Haxh në librin “Et-Tekrirë alet-tekrirë” thotë: “Disa Hanbelijë thonë se, nëse argumenti forcohet ose është

njeri i rëndomtë, nuk mëkaton.” Në **“Revdan”** e Nevevijut është tregimi nga Ibn Ebi Hurejre se nuk mëkaton.

El-Iz Abdus-Selam ka thënë: “Njeriu i rëndomtë le të veproj me lehtësimet e medhhebeve, mohimi i kësaj është injorancë e atij i cili e mohon sepse të vepruarit me çështjet lehtësuese është e pëlqyer. Feja e Allahut është lehtësim dhe Allahu nuk ka bërë vështirësi në fe.

Tema e pestë: Çka ekziston në mes të pyetësit dhe muftisë dhe kushtet e të pasuarit

Mufti është muxhtehidi apo fekihi,⁶⁹ i cili që jetë autoritet për fetva, ashtu siç e kemi cekur më herët, duhet t'i plotësoj kushtet e ixhtihadit, dhe kjo e përfshin çdonjërin i cili ka aftësi për përfitime dhe argumentime dhe ato çka bashkëngjiten për të pasur aftësi, për të ditur të favorizoj dhe të jep konkludime.

Dallimi në mes të ixhtihadit dhe iftasë është se iftaja është më e veçantë se ixhtihadi.

Ixhtihadi është përfitimi i ligjeve pa marrë parasysh a parashtrohet apo nuk parashtrohet pyetje për atë temë.

Iftaja nuk realizohet pa ndodhë ndodhia, e tek pastaj fekihi e mëson dhe e paraqet ligjin për atë ndodhi.

Fetvaja e shëndoshë nuk kërkon kushte tjera përpos kushteve të ixhtihadit, përpos që në rend të parë duhet të dijë ndodhinë për të cilën pyetet, njohurinë mentale të pyetësit, shoqërinë në të cilin jeton ai, ashtu që të mësoj (të dijë) se çfarë ndikimi do të ketë fetvaja tek pyetësi, ndikim pozitiv apo negativ?⁷⁰

Mirëpo, më vonë fjala mufti është shndërruar në kuptimin, fekihi i medhhebit të medhhebeve, ku veprimtaria e tij përkufizohet vetëm në bartjen e teksteve nga librat e fikhut. Ky kuptim ka të bëjë vetëm në kuptim alegorik, ndërsa kuptimi i drejtë i fjalës tradicionale është në përputhshmëri me termin tradicional të përgjithshëm dhe si terminologji e qeverive.⁷¹

Pyetësi (ai i cili ka të drejtë të pasoj) – është ai i cili nuk është kompetent për ixhtihadë, pa marrë parasysh a është vetëm njeri i rëndomtë, i cili nuk ka njohuri shkencore për të arritur nivelin e ixhtihadit, ose që ka njohuri në disa lëmi shkencore të cilat llogariten në nivelin e ixhtihadit, siç kemi sqaruar më herët.⁷²

Çështja e kërkuar – është çështja presupozuese e ixhtihadit, është ajo për të cilën lejohet të bëhet ixhtihadë, dhe lejohet të pasohet mendimi (deklarata) i muftiut dhe nuk është çështje shkencore,⁷³ siç e kemi sqaruar edhe më herët.

Për muftiun, të cilin lejohet që të pasohet, dijetarët kanë paraparë kushte të shumta, siç janë:

- mendja e shëndoshë,
- pjekuria,
- liria,
- drejtësia,
- dituria, dhe
- gjallëria.

Ne do të kufizohemi në sqarimin e kushteve si në vijim, dituria dhe drejtësia, ngase për këto ka mospajtime dhe për shkak se janë të rëndësishme.

Këto dhe, Shafiijet kanë deklaruar se femra ka kompetencë për ixhtihadë.

Para se t'i sqaroj këto, është mirë që shkurtimisht të shpjegoj për fetvatë e atij i cili nuk është muxhtehidë i medhhebit, por muxhtehidë i cili jep fetva me mendimin (absolut) e tij.

Fetvaja e muxhtehidit i cili nuk është muxhtehidë i medhhebit të ndonjë imami

Dijetarët janë pajtuar që, i pasuari, i cili i jep fetva tjetrit nga ajo çka ka mësuar nga medhhebi i muxhtehidit, është vetëm transmetues i medhhebit, mirëpo quhet mufti vetëm se është më e lehtë të thirret kështu, përderisa, nëse jepet fetvaja jo në bazë medhhebit të ndonjë imami (imamëve), atëherë duhet bërë dallimin se muxhtehidi a është i gjallë apo i vdekur?

Sa i përket muxhtehidit deri sa është gjallë, dijetarët kanë dhënë katër mendime të ndryshme:⁷⁴

1. Hasan el Basriju dhe një grup i dijetarëve kanë thënë se, ***nuk lejohet absolutisht, sepse ai sqaron atë çka është tek ai, dhe nuk sqaron atë që është te imami i tij.*** Gjendja e tij është se nuk ka njohuri për atë që është pyetur sepse nuk ka aftësi për ixhtihadë. Nëse jep fetva, ai ka dhënë fetva pa njohuri dhe nuk i pranohet, sepse po të lejohej fetvaja si formë tregimi nga medhhebi i tjetrit, atëherë do t'i lejohej (të jep fetva) edhe të rëndomtë, e kjo e fundit është në kundërshtim me ixhmain.

Replikë – Nëse i pasuari është kompetent për hulumtim, i cili ka njohuri për perceptimet e imamit të tij, i besohet atij se është njohës i medhhebit të imamit të tij, kështu që i pranohen fetvatë e tij, për shkak të diturisë së tij në atë se në çka është bazuar imami i tij, përderisa atij i cili është i paditur, i refuzohen fetvatë e tij.

2. Disa kanë thënë, dhe mendimin e tyre e ka përzgjedhur Err-Rraziju dhe el Bejdaviju, ***absolutisht lejohen fetvatë e tij***, duke u bazuar në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

فَاسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

“Ju pyetni pra dijetarët nëse ju nuk dini.” (En-Nahl : 43)

Ky i pasuar është i ditur në medhhebin e imamit të tij.

Replikë – ky ajet nuk zbatohet për atë i cili jep fetva nga imami i tij, sepse ai nuk është i ditur në atë, sepse fetvanë të cilën e jep është e medhhebit të imamit të tij dhe kësaj nuk pranohet mendimi i tij.

3. Disa kanë thënë, ***i lejohet atij fetvaja në rast domosdoshmërie, kur nuk ka muxhtehidë, dhe nuk i lejohet atij kur ka muxhtehidë***, sepse nuk është plotësuar kushti i domosdoshmërisë.

Replikë – Bazë e pranimi nga i pasuari është që, ai të jetë kompetent për hulumtim. Nëse është kompetent për hulumtim, i pranohet mendimi, e nëse nuk është kompetent për hulumtim, nuk i pranohet, ndërsa nuk merret për bazë ajo se ka apo nuk ka muxhtehidë.

4. Një grup i dijetarëve kanë thënë, ***i lejohet atij fetvaja nëse e shpalosë atë që e ka thënë imami i tij, i cili është kompetent për të hulumtuar bazën ligjore***, ka aftësi për selektimin e çështjeve dhe sqarimin e tyre në bazë të rregullave dhe thënies të tij, që do të thotë se muftiu duhet të ketë aftësi që të mund të përfiton dispozita detyësore, të cilat nuk janë raportuar nga imami i medhhebeve, por i ka përfituar nga bazat të cilat i ka vendosur ai imam. Ky quhet muxhtehidë i medhhebit.

Argument i lejimit është: Ixhmai i pranimi të çdo gjenerate rreth fetvave të kësaj natyre, e edhe sot njerëzit i pranojnë mendimet e të thelluarve në dituri nga secili medhheb prej medhhebeve të umetit, duke ditur për njohuritë e tyre, siç janë, Ibnul Kasimi dhe Eshheb prej medhhebit Malikijë, Ebu Jusufi dhe Muhamedi nga medhhebi Hanefijë, Mezeniju dhe Bujutiu nga medhhebi Shafijë. Njerëzit nuk i kanë mohuar fetvatë e tyre, edhe pse i kanë mohuar të tjerëve. Kjo llogaritet ixhmaë në bazë të thënies të tyre. Fukahatë e shkollës së Kufes i nxirrin përgjigjet e çështjeve nga thëniet e shokëve të tyre, pasi që posedonin mençuri, mprehtësi dhe shpejtësi për ta bartur çështjen prej një çështjeje në çështje tjetër.

Përderisa, sa i përket rastit kur muxhtehidi është i vdekur, papajtueshmëria del në sipërfaqe, siç do ta shpjegoj te kushtet e të pasuarit.

Kushtet e të pasuarit

Dijetarët kanë paraparë shumë kushte për te i pasuari, siç janë: mençuria, liria, pjekuria.

Disa prej këtyre kushteve do t'i sqaroj veç e veç, e ato janë: gjallëria, dituria dhe drejtësia.

1. Kushti i gjallërisë për muxhtehidin që pasohet

Dijetarët nuk janë pajtuar sa i përket lejimit të pasimit të të vdekurit, veprimit me mendimin e tij dhe me fetvatë e tij. Për këtë kemi katër mendime:⁷⁵

1. **Lejimi absolut i pasimit të të vdekurit.** Imam Shafiiu ka thënë: Medhhebet nuk janë zhdukur me vdekjen e prijësve të tyre, që do të thotë se: Medhhebet janë gjallë me argumentimet e tyre me të cilat janë argumentuar. Ky është mendim i shumicës së dijetarëve, mirëpo, normal që duhet kushtëzuar saktësia në transmetimin e thënieve të tyre.

2. **Absolutisht nuk lejohet.** Këtë e ka thënë Rraziju dhe këtë mendim e mbështetin edhe shiitët.⁷⁶

3. **Lejohet pasimi i të vdekurit, por me rast nevojë.** Ndërsa nëse nuk ka nevojë, nuk lejohet. Ky është mendim i disa prej tyre.

4. **Lejohet ajo që është raportuar prej tyre nëse nga ai ka raportuar muxhtehidi i medhhebit të tij** sepse duke i njohur perceptimet e tij e ka vazhduar sqarimin prej tij siç i ka dalluar ai çështjet dhe të cilat nuk do t'i kishte vazhduar çështjet tjera.

Argumentet

Do ti përmendi vetëm argumentet e pranuesëve dhe mohuesëve⁷⁷, përderisa argumentet e e atyre të cilt bëjnë dallimin vetem se e kam sqaruar

Mohuesit janë argumentuar si në vijim:

E para: Lejohet që muxhtehidi ta ndryshojë mendimin e tij para vdekjes së tij dhe kur ta ndryshoj këndvështrimin e tij sepse mund të kthehet nga mendimi i tij i parë.

E dyta: I vdekuri nuk vazhdon të jetë i gjallë me mendimin e tij, se argumentim i kësaj është themelimi i ixhmait pas vdekjes së mendimtarit kundërshtues (të asaj çështje për ixhmaë). Po të ishte valid mendimi i tij pas vdekjes së tij, nuk do të ishte themeluar ixhmai pas vdekjes së tij sepse mendimi i tij do të kishte vazhduar të qëndroj si mendim valid, ende do të ishte i qëndrueshëm kundërshtimi i tij. Dhe pasi që i vdekuri nuk e ka në fuqi mendimin e tij, atëherë nuk lejohet pasimi në të dhe as në fetvatë që janë dhënë prej tij.

Ata kanë thënë: Sa i përket vlerës së përpilimit të librave nga medhhebet, pas vdekjes së prijësve të tyre, vlera e këtyre është nga rruga e ixhtihadit si i kanë vështuar ngjarjet, dhe mënyrën se si i kanë realizuar mendimet prej atyre çështjeve, dhe për të mësuar se në çka janë pajtuar dhe në çka nuk janë pajtuar.

Replikë ndaj këtij argumenti – Ne nuk e pranojmë themelimin e ixhmait me vdekjen e muxhtehidit kundërshtues të asaj çështjeje, për këtë janë pajtuar të gjithë, sepse disa dijetarë mendojnë se mendimi kundërshtues vazhdon të funksionoj dhe nuk ka ixhmaë për shkak të atij kundërshtimi. Përpos kësaj, ky argument me të cilin janë argumentuar është në kundërshtim dhe nuk përputhet me atë se argumentimi i ixhmait është argument edhe pas vdekjes së të gjithë atyre të cilët kanë vdekur pas miratimit të ixhmait. Po të kishte qenë se me vdekjen e mendimtarit vdes

edhe mendimi i tij (për atë çështje) atëherë edhe ixhmai nuk do të ishte argument sepse me vdekjen e miratuesve të ixhmait nuk do të merrej parasysh ixhmai i tyre.

Lejuesit janë argumentuar me atë se, po të mos lejohej pasimi në të vdekurin, do të shkaktohej ç'rregulli në njerëzit, në veprimtaritë e tyre dhe po të mos ekzistonte muxhtehidë i cili do t'u jepte fetva për çështje të fesë së tyre njerëzit do të binin në vështirësi. Po të zhvlerësohej mendimi i muxhtehidit me vdekjen e tij, asgjë nuk do të merrej parasysh prej fjalëve të tij, si f.v., raportimet e tij, dëshmitë e tij, testamentet e tij. Përderisa, informatat e zakonshme nuk konsiderohen të pavlefshme me vdekjen e transmetuesve dhe raportuesve, kështu edhe thëniet (fetvatë) nuk asimilohen me vdekjen e thanësit të tyre⁷⁸.

Kjo dhe... Profesori el-Hakim⁷⁹ ka vërejtur se lejimi në bazimin ndaj të vdekurve në pasim, ka shkaktuar paralizimin e aktivitetit ideor shëriativ dhe ngurtësimi i mendjeve zhvilluese për të prodhuar ide të reja.

Unë nuk e mendoj se ky është shkak i ngurtësimit të dijetarëve, por te ta ka ndikuar ideja e atyre të cilët kanë thënë se dera e ixhtihadit është mbyllur vendim të cilin e kanë sjellë kushtet dhe rrethanat e përkohshme historike, pa pasur mundësi të sjellin ide se si duhet vepruar në të ardhmen dhe pa ditur ta interpretojnë çështjen se si duhet vazhduar dhe zhvilluar në të ardhmen dhe argumentimi im është se mendimet të cilat i kanë sjellë për çështjen e pasimit të të vdekurit është në kundërshtim me mendimin e dijetarëve të mëvonshëm për mbylljen e derës së ixhtihadit,⁸⁰ sepse gjithçka që mund të themi për këtë çështje është se, lejohet pasimi (taklidi) i të vdekurit, por nuk është e domosdoshme.

Unë e përkrahi mendimin për pasimin e të vdekurit dhe mendimin e dijetarëve të mëvonshëm të cilët thonë se është e lejuar, por me kusht që mendimi të jetë raportuar saktësisht prej tij dhe njohja e argumentimit në të cilin është mbështetur në sqarimin e dispozitës (ligjit). Por, nëse vërehet diçka se duhet ndryshuar ligji për shkak të interesit, ose duke pasur parasysh traditën, atëherë para neve ekziston mundësia e ndryshimit, sepse muxhtehidi gjendet edhe në mesin tonë.

2. Dituria e të pasuarit.

Më parë e kemi përmendur – te tema e të pasuarit – se te analistët e usulit thuhet se njeriu i rëndomtë dhe ai i cili nuk është kompetent për ixhtihadë kur t'i paraqitet çështja dhe që ta kuptoj ligjin i cili ligjësohet, duhet të pyes të diturit.⁸¹

Këta analistë janë pajtuar se është obligim për njeriun e rëndomtë të pyes dhe për lejimin e pyetjes ndaj atij i cili njihet se ka njohuri dhe kompetencë për ixhtihadë, është i devotshëm, fetarë dhe i drejtë, dhe që mendon se është i denjë për fetva dhe njerëzit pajtohen që ta pyesin dhe të kërkojnë fetva prej tij dhe kanë besim tek ai.

Nuk lejohet që njeriu i rëndomtë të pyes atë tek i cili dyshon se ka dituri, apo atë i cili nuk është fetar dhe që i ka cilësitë e kundërta prej asaj të cilat i përmendëm më parë.

Po ashtu nuk lejohet që ta pyes atë të cilin nuk e di se a ka apo nuk ka dituri sepse mund të ndodhë që pyetësi dhe i pyeturi të jenë të një niveli të diturisë, bile mosdituria është cilësi më prioritare se sa cilësia e diturisë dhe ixhtihadit sepse te njohuria, esenciale është padituria.⁸²

Bazuar në këtë: Nëse në një vend ekziston vetëm një mufti dhe nuk ka tjetër, njeriu i rëndomtë duhet t'i drejtohet atij. Por, nëse janë një grup i dijetarëve dhe muftive, atëherë cili prej tyre duhet pyetur?

Në lidhje me këtë çështje, dijetarët e usulit kanë dhënë mendime të ndryshme:⁸³

Një pjesë e dijetarëve kanë thënë: Njeriu i rëndomtë duhet të pyes më të mirin në dituri, devotshmëri dhe fetari. Nëse janë të barabartë në këto cilësi, atëherë e pyet cilindo. Në këtë drejtim është edhe Ahmed Ibni Serijxhi, Kafali Shafijj, Ebi Is'haku el-Isfrainiju dhe Ebil Hasani et-Taberiju, i njohur si Kiba el-Herasiju.

Gazaliu e përzgjedh dhe konfirmon se nëse sipas bindjes së tij njëri prej muftive është më i ditur dhe më me vlerë, ai duhet ta ndjek atë. Në librin *“Mustesfa”* ai thotë: ***“Tek unë, prioritare është se duhet të ndiqet më i miri.”***

Kush ka bindje se Shafiiju r.a. është më i mirë dhe se ai medhhebet është dominant, atij nuk i lejohet të marr nga medhhebet tjera sipas apetiteve.⁸⁴ Ky mendim është i njohur te Shafijët, bile pretendojnë se për këtë është miratuar ixhmai.⁸⁵

Bindja se: medhhebi i të pasuarit edhe pse është i drejtë mund të jetë i gabuar, bazohet në atë se nuk lejohet të pasohet mendimi i më të dobët dhe pasuesi duhet t'i përmbahet medhhebit të tij.

Shumica e dijetarëve të usulit dhe fukahave, prej tyre Hanefijët, Malikijët, shumica e Hanbelijve dhe Shafijve, deklarojnë se, njeriu i rëndomtë zgjedh që të pyes cilindo prej dijetarëve, pa marrë parasysh a janë të barabartë apo njëri është më i mirë se tjetri. Është e njohur shprehja e tyre: **Lejohet pasimi i nivelit më të ulët të diturisë edhe pse ekziston tjetri me më shumë dituri.**⁸⁶

Argumentet

Argumentimi i grupit të parë është në atë se, sa i përket njerëzve (publikut) mendimet e muxhtehidëve janë njësoj sikurse argumentet dhe faktet e kundërta te muxhtehidi, njeriu i rëndomtë duhet t'i favorizoj, nuk ka favorizim përpos favorizimit të vlerës dhe diturisë sepse dituria është më e fuqishmja. Mënyra për të kuptuar diturinë është ose në bazë të përvojës dhe eksperiencës ose nëpërmjet tolerancës, famës dhe faktit se njerëzit orientohen tek ai.

Ky krahasim replikohet me atë se është i paqëndrueshëm ndaj ixhmait të sehaveve, të cilët nuk e kanë mohuar të vepruarit me mendimin më të dobët, kur përballë atij mendimi ka pasur mendim më të fuqishëm.

Po ashtu replikohet me ekzistimin e dallimit në mes të njeriut të rëndomtë dhe muxhtehidit sepse muxhtehidi e ka më lehtë të favorizoj një mendim prej dy mendimeve të kundërta, e e kundërta është te njeriu i rëndomtë sepse ai edhe pse ndonjëherë mund të dalloj se cili është dijetari

më i mirë, herëve tjera e ka më të vështirë, ndonjëherë çështja për të është e pamundur.

Kundër replika në këtë është se favorizimi mund të bëhet me atë se te cili anon peshorja më shumë dhe kjo ka mundësi sepse dëgjueshmëria realizohet në bazë të mundësive.

Grupi i dytë argumentohet me Kur'an, me ixhmain e sahabeve dhe me argumentin logjik.

1. Argument nga Kur'anit:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

فَاسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

“Ju pyetni pra dijetarët nëse ju nuk dini.” (En-Nahl : 43)

Ky ajet është absolut, nuk e bën dallimin në mes të më të diturve dhe dijetarëve tjerë, pasi që zakonisht dijetarët dallohen prej njëri-tjetrit me anë të diturisë.

Replikë ndaj argumentimit të këtij ajeti, ngase nuk i përfshin dijetarët të cilët japin mendime të ndryshme me fetvatë e tyre, pasi që njeriu nuk mund të sjell nga Ligjvënësi çështje kundërthënëse, por ka të bëjë me rastet pajtuese të fetvave dhe kjo nuk është ashtu siç ata pretendojnë.⁸⁷

Argumentimit nga shahabet:

Shahabet janë pajtuar për lejimin e fetvasë për çdo sahabij, edhe të më të dijshtit por edhe të tjerëve të cilët nuk ishin në rangun e tyre edhe pse ishin muxhtehidë, duke mos e mohuar asnjërin i cili ka vepruar me mendimin më

të dobët përballë mendimit më të fuqishëm. *Ky veprim ka qenë ixhmaë i tyre.*

El-Amediu ka thënë: Prej sehaveve muxhtehidë ka pasur të vlefshëm dhe më të vlefshëm. Katër halifet, për rrugën e ixhtihadit, kanë qenë më të ditur se të tjerët, për këtë arsye pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Veproni me sunetin tim dhe me sunetin e halifeve të drejtë të udhëzuar, përmbahuni te ata dhe shtrëngohuni fort me ta.”**⁸⁸

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Gjykatësi më i mirë prej juve është Aliu. Njohësi më i mirë prej juve është Zejdi. Njohësi më i mirë i hallallit dhe haramit është Muadh ibn Xhebeli.”**⁸⁹

Në mesin e sehaveve ka pasur të rëndomtë. Ka pasur prej tyre aso që e ka obliguar veten që të pasoj muxhtehidët, të pranoj mendimin prej tyre dhe jo të tjerëve, por prapëseprapë nuk na është raportuar nga asnjëri prej sehaveve e as të mëvonshmëve, që njerëzit e rëndomtë detyroheshin të vepronin me ixhtihadin e ndonjërit prej sehaveve dhe asnjëri prej tyre nuk e ka mohuar tjetrin pse e ka marrë mendimin më të dobët ndaj më të fortit dhe nuk është ndaluar kërkimi i fetvave prej tyre edhe pse kanë ekzistuar sehave më të dijshtëm. Po të mos kishte qenë e lejuar, sehabet nuk do ta lejonin, por ata janë harmonizuar që të mos e mohojnë dhe të mos e pengojnë një gjë të tillë.⁹⁰

Për këtë, imam Gazaliu dhe Amediju kanë thënë: *“Po mos të kishte qenë ixhmai i sehaveve, medhhebi i kundërshtarit do të kishte pasur prioritet.”*

Ky argumentim replikohet me atë se nuk ka argument se është miratuar ixhmai (i sehaveve) në lidhje me këtë çështje sepse nuk tregon mosraportimin e obligimit për të rëndomtit që të mos kërkojnë mendim nga muxhtehidë të caktuar. Patjetër duhet të ekzistoj teksti se në kohën e tyre nuk ka pas divergjenca. Por edhe po të pranohet miratimin e ixhmait, nuk tregon mënyrë të prerë për formën e mendimeve të ndryshme për një dispozitë, por ekziston dyshimi se njerëzit e rëndomtë nuk bënin dallimin e Aliut në njërin anë me Ebi Sufjanin në anën tjetër, me Jesr bin Ertain dhe Mervanë bin el-Hakemin në anën tjetër.

Argumenti logjik – është e pamundur që njeriu i rëndomtë të bëjë favorizim në mes të dijetarëve.

Replikë – Këtë mund ta realizoj duke dëgjuar, duke i parë dëshmitë dhe duke i parë dijetarët se si i drejtohen atij dijetari elitar dhe eksperienca e cila e përcakton atë.

Unë mendoj se pasimi i më të diturit është rruga më e drejtë për të kuptuar sekretet e ligjeve, *siç thotë grupi i parë*, mirëpo, megjithatë nuk duhet ta injorojmë faktin e gjendjes së njerëzve të rëndomtë të cilët nuk bëjnë dallimin, siç edhe është fakt, në mes të njeriut të ditur në nivel të lartë dhe personit i cili ka dituri të nivelit më të ulët. Kështu që, në kohën moderne duhet t'i ndajmë jomuxhtehidët dhe intelektualët dhe njerëzit e rëndomtë.⁹¹

- Të parët duhet të orientohen te më të diturit, më fetarët dhe më të shkëlqyerit, dhe këtë e arrijnë nëpërmjet rrugëve të ndryshme, posaçërisht nëpërmjet kuvendimeve dhe debateve të ndryshme dhe me krahasimin e fetvave, ndërsa,

- Të tjerëve u lehtësohet duke pasuar ata të cilëve u besojnë me atë njohuri që kanë.

Këtë mund ta presupozojmë në shoqërinë e sehaveve sepse disa prej tyre, në fakt pyesnin sehabet më eminent dhe prej tyre kërkonin fetva, prej sehaveve më eminent.

Sa i përket bedunit në shkretëtirë, askush nuk e obligon atë të shkoj te muxhtehidët. Kjo çështje është dëshmuar edhe gjatë historisë edhe pse aty-këtu ka mospajtime, duke na u raportuar se ka ndodhur përhapja e fetvave dhe janë përhapur lajme se kanë shkuar te muftitë, mirëpo përderisa na është raportuar, dëshmohet se lejohet pasimi i sehaveve në lehtësimin për njerëzit e rëndomtë, duke i pyetur dijetarët për sa kanë pasur mundësi dhe nuk ka pasur nevojë për tekst ligjor (nas) përderisa nuk ka pasur mospajtime sepse biografia e sehaveve nuk ka qenë shumë e njohur dhe për këtë çështje nuk duhet ngulfatur në fe, apo nuk duhet insistuar vetëm në teoritë të cilat i kanë paraparë muxhtehidët të cilët kanë qenë të përshtatshëm vetëm për kohën e tyre, përderisa janë përzier qëllimet e mira me qëllimet jo të mira dhe

interesat e grupacioneve gjë e cila ka ndikuar që umeti islam të ndahet në sekte dhe në grupacione të ndryshme.

Drejtësia e muftisë (të pasuarit)

Drejtësi – gjuhësisht nënkupton, peshimin (matjen) mesatar të çështjeve, as duke i lënë mangët dhe as duke i tepruar.

E drejtë – nënkupton **mesataren e artë**. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا

“Dhe Ne kështu u kemi bërë popull mesatar.” (El-Bekare : 143) që do të thotë popull **të drejtë**.

Ndonjëherë fjala drejtësi përdoret edhe për çështjen e cila është e kundërta e dëmit.

Ndonjëherë quhet për punët e mira në të cilat një njeri i ndihmon tjetrit. Mbreti i cili kujdeset dhe sillet mirë me popullin quhet i drejtë.

Në gjuhën juridike, përdoret fjala drejtësi ndërsa qëllimi është për individin të cilit i pranohet dëshmia ose për transmetuesin të cilit pranohet transmetimi (hadithi) nga Muhamedi a.s.

Gazaliu e definon kështu: **“Drejtësi është shprehja e qëndrueshmërisë së fortë në fe.”** Për të arritur këtë cilësi duhet të kthehemi në pozitën e thellë të brendshme shpirtërore e cila e obligon njeriun për burrëri, ndershmëri, deri sa të përfitoj besimin e tjerëve me sinqeritetin e tij dhe kjo arrihet duke u larguar nga mëkatet e mëdha, nga mëkatet e vogla dhe nga disa çështje të lejuara.⁹²

Fetvaja në fe është sfera më e rëndësishme në të cilën kërkohet drejtësia, për këtë arsye ka shumë mospajtime për këtë çështje. Këtë cilësi si kusht e

parashohin shumica e dijetarëve të sunetit dhe shiitët. Ata thonë: **“Njerëzit nuk duhet të kërkojnë fetva prej dikujt tjetër pos prej atij i cili njihet si muxhtehidë dhe i drejtë.”** Nëse nuk i dihet ixhtihadi i tij, nuk kërkohet fetva prej tij, siç kemi sqaruar më herët, sepse ixhtihadi është kusht për t’u pranuar fetvaja, e patjetër se i pyeturi duhet ta ketë këtë kusht. Po ashtu edhe atij të cilit nuk i dihet drejtësia e tij nuk pyetet vetëm se pas hulumtimit dhe kërimit të drejtësisë së tij dhe marrjes së përgjigjes prej një apo dy personave se është i drejtë, atëherë anon mendimi se ai është i drejtë, ose që njihet në shoqëri si i drejtë.⁹³ E, e kundërta është për mëkatarin, ku në fjalët e tij hidhet dyshim, dhe i cili nuk njihet si i mirë dhe nuk lejohet të gjykojë në shoqëri dhe nuk lejohet të pranohen fetvatë prej tij. Për këtë arsye kanë thënë: **“Dijetari i padrejtë i sjell padrejtësi shoqërisë.”**⁹⁴ sepse ai është në qendër të vëmendjes dhe të udhëheqjes dhe njerëzit i pasojnë udhëheqësit e tyre.

Këtë kuptim ia japin dijetarët edukimit të muhadithit dhe te dijetari e kushtëzojnë që të jetë shembull për të mirë, ashtu që studentët të motivohen prej tij. Nuk ka vlerë fjala nëse nuk përputhet me veprën:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لِمَ تَقُولُونَ مَا لَا تَفْعَلُونَ ﴿٢﴾ كَبُرَ مَقْتًا عِنْدَ اللَّهِ أَنْ تَقُولُوا مَا لَا تَفْعَلُونَ ﴿٣﴾

“O ju që besuat, pse po e thoni atë që nuk e punoni? Te All-llahu është shumë e urryer ta thoni atë që nuk e punoni!” (Es-Saf : 2, 3)

Në bazë të atributit të drejtësisë muftiu duhet t’i ketë parasysh tri çështje si në vijim, për të zgjedhur një mendim prej mendimeve të medhhebeve:

E para: Që fjala të pasohet me argumentin, të mos e zgjedh mendimin e medhhebit me argumentim më të dobët, por të zgjedhë mendimin me argumentimin më të fuqishëm.

E dyta: Që të angazhohet në maksimum në ixhtihadin e tij dhe të mos e anashkaloj mendimin në të cilin janë pajtuar për ta marrë mendimin për të cilin nuk janë pajtuar.

E treta: Që të mos i pasoj epshet dhe dëshirat e njerëzve, por të shikoj interesin me argumentim, interesi i padefinuar është interes i mjaftueshëm.⁹⁵

Fusnotat:

1. “Sherhul Mehalij ala xhemil xhevamiu”, 2/322.
“el-mustesfa”.
“el-Amediu”.
“et-Tekrirë vet-Tehbirë”.
“Fevatihu Rahmut Sherh muslimu Thubutë”.
“Revdatu Nadhir”.
“el-med-hal ila medhhebi Ahmed”.
“Irshadul Fuhulë.”
“Sherhul Udadi ala muhtesar Ibni Haxhib”.
“el-anavijn ala mesailil Usulijeti”.
“Usulul Istinbatë”.
2. “Kavlul mufidë fi ediletil ixhtihadi vet-Teklidë”, 108.
3. “err-Rred ala men ehlede ilel erdi”, 44, es-Sujutiju.
“Tuhfetu Rreëji Sedidë”.
“Iëlamul mukiiijn”, 2/178, 222; 4/124.
4. El-Hashvije – ata të cilët e shikojnë vetëm pjesën e jashtme të ajetit, ata janë antropomorf, janë sekt i larguar nga e vërteta. Quhen kështu sepse kanë qenë në një ligjëratë të Hasan el Basriut dhe ai i sheh se po bisedojnë në mes vete, dhe el-Basriu u thotë: Këta dëshirojnë ta turbullojnë ligjëratën (hasha-u). Për këtë arsye janë quajtur hashaaë.
Ata janë hashevij.
Thuhet se janë quajtur ashtu sepse janë antropomorf. Për arsye se dërrasa është trup, për këtë arsye janë quajtur hashvije.
5. “Muslimu thubutë”.
“el-mustesfa”.
“el-Amediu”.
“el-med-hal ila medhhebi Ahmed”.
“Irshadul Fuhulë”.
“Usulul fikh”.
“Umdetu Tehkikë fit-teklidë vet-telfikë”, 49, el-benanju.
“Sherhul Esnevij”, 3/264.
6. Transmeton Ibni Merdevejhi dhe Abdun bin Hamidë dhe Ibnu Ebi Hatim dhe Ibni Habani në sahihun e tij nga Atai (“Tefsirë ibni Kethirë”, 1/440).
7. Ed-Devr - ekzistenca e çështjes nga vetvetja e tij, pa u mbështetur në diçka tjetër. Kjo çështje logjikisht është e pavlefshme. Ky është kuptimi logjik: Pavlefshmëria e të ekzistuarit të çështjes nga vetvetja e tij, që do të thotë, është i pavlefshëm mendimi se, çështja është shkaktar i ekzistimit të vet çështjes.
8. “el-mustesfa”.
“Fevatihu Rahmut sherh muslimu Thubutë”, 2/401.
“Tuhfetu Rreëji Sedidë”, 37.
“Sherhul Esnevij”, 2/264.
9. “el-mustesfa”, 2/124.

10. E ka regjistruar Tirmidhiu nga Hadithi i Ebu Hurejres r.a. në formulimin: Janë shkatërruar ata të cilët kanë qenë para jush, atëherë kur janë ngatërruar për këtë çështje. (“Xhamiul Usulë”, 10, 528).
11. “el-mustesfa”, 2/124.
12. “el-ihkam fi usulul Ahkam”, 6/793, Ibni Hazm.
 “Mulahas Ibtalil Kijas verr-rreëji vel istis’hanë vet-teklidë vet-tealilë”, 52.
 “el-Amediju”, 3/170.
 “Sherhul Esnevi”, 3/261.
13. “Err-rred men ehled alel erd”, 52.
14. “el-ihkam fi usulul Ahkam”, 6/861.
15. “Risaletu fi usuludh-Dhahirijeti”, 31.
16. “el-mustesfa”, 2/123.
17. “Muslimu Thubut”, 2/351.
 “el Amediu”, 3/170.
 “el-mustesfa”, 2/124.
 “Irshadul Fuhulë”, 236.
 “Fetava Shejh Alishë”, 1/60.
18. Ibid.
 “el-Kavlul mufidë fi ediletil ixhtihadi ve teklidë”, 3,4, Shevkaniu.
 “Iëlamul mukiijn”, 2/237.
19. E kemi treguar regjistrimin përpos me fjalën “në islam”.
 E transmetojnë Maliku dhe Shafiû si hadith mursel, pastaj Abdurr-Rrezaku, Ibn Maxhe, Taberaniu nga Ibn Abasi në zinxhirin në të cilin gjendet Xhabir el Xhafiu, por është i dobët.
 E ka regjistruar Ibn Ebi Shejbete dhe Darukutniu në zinxhir tjetër – ky hadithë ka edhe rrugë tjera, është hadithë i mirë.
 Është transmetuar nga Ebi Seidi dhe Ebi Hurejre dhe Xhabiri, Ajshja dhe të tjerët (“Keshful Hafa”, “esnel metalib”, “Mekasidul Hamsete”).
20. “el-Amediu”, 3/170.
21. Transmeton el-Bejhekiu në librin “Shuabul iman”, Ibn Maxhe, Ibnu Abdul Berri nga Enesi. Siç thotë Sujutiu është hadithë sahihë.
22. E ka regjistruar Buhariu dhe Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu nga Ali bin Ebi Talib r.a. në formulimin: Veproni, se çdo lehtësim është për atë që është krijuar. (“Xhamiul usulë”, 10/515).
23. “Iëlamul mukiijn”, 2/168
 “Tuhfetu Rreëjete Sedidë”, 39.
24. “Err-Rred ala men ehlede ilel erd”, 42.
 “el-Kavlul mufidë fi ediletil ixhtihadi”.
 “vet-teklidë”, 17, Esh-Shevkanu.
 “Iëlamul mukiijn”, 2/181.
 “Err-Rrisalete”, 42, Shafiû.
25. “Irshadul Fuhulë”, 236.
26. “el-Amediu”, 3/170.
 “Muslimu Thubutë”, 2/351.

- “el-Mustesfa”, 2/121.
 “Sherhul Esnevi”, 3/291.
27. “Irshadul Fuhulë”, 236.
 “Umdetu Tahkikë fit-teklidë vet-telfikë”, 53.
28. “el-mustesfa”, 2/121.
 “el-ihkam”, 3/158, el-Amediu.
 “Sherhul Esnevi”, 3/261.
 “Mudhekeratë fi usulil fikhi”, 251, shejh Zekirë.
 “Muhtesar Ibni Haxhib.”
 “Iëlamul mukiijn”, 2/185.
29. Ibid.
30. Ibid.
31. “Iëlamul mukiijn”, 4/215.
32. “Iëlamul mukiijn”, 2/211.
33. “el-muvafekat”, 4/118.
34. 2/135, botues “Istikametu”.
35. “Err-Red ala men ehlede al el erdi”, 61.
 “Iëlamul mukiijn”, 4/214.
36. “el-Amediu”.
 “Muslimu Thubutë”.
 “Irshadul Fuhulë”.
 “Sherhul Esnevi”.
 “Sherhul mehalij ala xhemul xhevamiu”, 2/328.
 “et-Tekrirë vet-Tehbirë”.
 “Fevatihu Rahmutë”.
 “el-med-hal-ila medhheb Ahmed”.
 “el-anavijn ala mesailul usulijeti”.
 “umdetu Tehkikë fit-teklidë vet-telfikë”, 81.
 “Usulul Fikhi”, 337, Shaëbanë.
37. Bazuar në këtë, dy persona nuk e kanë të patjetërsueshme të përmbahen në një medhheb derisa ata janë të rëndomtë. Nuk i lejohet atij edhe nëse është i një medhhebi, por medhhebi i tij është kur për çdo ngjarje ai është i atij medhhebi prej të cilit e merr fetvanë. Po ashtu edhe ai i cili ka një lloj eksperience me medhhebet, dhe i analizon argumentet. Nuk e ka të patjetërsueshme t’i përmbahet një medhhebi të caktuar.
38. Fetvatë e profesor Alishit (“Fethul alijul Malik fil fetva ala medhheb Malik”, 1/59; Ibid, 578).
39. “Muslimu Thubutë”.
 “Sherhul Esnevi”.
 “Umdetut-Tehkikë fet-teklidë vet-telfikë”, 85.
 “Mudhekeratë fi usulul fikhi”, 260, Zekirë.
40. “Muslimu Thubutë”, 2/352.
41. “Umdetu Tehkikë fit-teklidë vettelfikë”, 86.
 Muhamed Sejid elbani.

42. Kjo ndodh kur për një ndodhi veprohet me dy mendime, ose vepron duke mbetur gjurmët e tjetrit.
43. “Sherhul Esnevi”, 3/266.
 “Umdetu tehkikë fit-teklidë vet-telfikë”, 91.
 “Tuhfetu Rreëji Sedidë”, 5-79, el-Husejniji.
44. “Sherhut-Tenkihë”, Ibid.
45. Ibid.
46. Në realitet këtu ekziston dallim në mes të dy anëve:
 E para: Kur të paraqitet mendimi i tretë, menjëherë duhet të unifkohet çështja, përderisa te pasimi çështja është e shumënumërt.
 E dyta: Në bazë të mendimit të preferuar në çështjen e përzierjes nuk ka anë të pajtueshmërisë.
 Në çështjen e abdesit është bosht i debatit në mes të dijetarëve, ndërsa prishja e abdesit me prekje të gjinisë femërore (dhe anasjelltas) është çështje tjetër. Në të dy çështjet ka mospajtime. Përzierja e tyre nuk do të thotë shpartallim i asaj pjese për të cilën janë pajtuar. Kjo analogji është e pa bazuar. (“Eb’hathul muëtemerul-ev-vel li mexhmeal buhuth”, 95).
47. Mungon.
48. Mungon.
49. “Resmul mufti Hashijetu Abidijn”, 1/69.
 “El-Ihkam fi temjizil fetava anil Ahkam”, 250, el-Karafiu.
50. “Umdetu Tehkikë”, 106.
51. “et-Tekrirë ve sherhihi”, 3/350.
52. “Hashijetud-Dusukiju ala sherhil Kebirë”, 1/20.
53. “Umdetu Tehkikë”.
 “el-Ihkam fi temjizil fetava anil Ahkam”, 79, Karafiu.
 “Fetava”, /68-71, shejh Alish.
 “Resmul mufti”, 1/69, Ibni Abidijn.
54. “el-mustesfa”, 2/125.
55. Sepse shkurorëzimi nuk ka ndodhur në atë çast, ndërsa ka dashur të kontraktoj akt të ri.
56. Do të thotë: Mendimi i moslejimit nuk është vetëm për shkak të përzierjes së medhhebeve, por për shkak se është mënjeluar prej asaj çka ka pasuar, pasi që ka vepruar dhe ende i ka gjurmët e saj.
57. “Umdetu tehkikë”, 127.
58. el-verë - të larguarit nga të dyshimtat dhe ndalimi i veprimit të tyre prej frikës së Allahut, pastaj njeriu largohet edhe prej Allahut.
59. Mut-tefikun alejhi në mes të Buhariut dhe Muslimit gna hadithi i Ebu Hurejres r.a. në librin “Sherh sahihul muslim”, 2/101.
 “Rijadus-Salihinë”, 83.
60. Bejhekihi nga hadithi i Ibni Mes’udit. Në të ka dobësi dhe ndërprerje. Zejnul Irakiju ka thënë: Nuk ka bazë. (“el-mekasidul haseneti”, 362).
61. Transmeton Tirmidhiu dhe Nesaiju nga Hasan bin Ebi Ali bin Ebi Talibi. Tirmidhiu ka thënë se hadithi është i mirë, i saktë.

62. “el-Eshbahu ven-nedhairu”, 1/98, Ibni Nexhimi.
 “El-Eshbahu”, 67, Sujutiu.
 Qëllimi me këtë rregull është se: Gruaja me të cilën synon të martohet në esencë është e ndaluar për burrin, dhe në atë ndalesë bëjnë pjesë të gjitha çështjet të cilat lejohen në bashkëshortësi.
63. “Sherhul mehalij ala xhem’ul xhevamiu”, 2/368.
 “Muslimu Thubutë”, 2/352.
 “el-muvafekatë”, 4/123, Shatibiu.
 “Irshadul Fuhulë”, 240.
 “el-mustesfa”, 2/125.
 “Sherhul Esnevi”, 3/266.
 “Mudhekerat fi usulil fikh”, 260, Shejh Zehirë.
 “el-med-hal ila medhheb Ahmed”, 195.
 “Fetava”, 1/58-77, shejh Alish.
 “Tebisiretul ehkam”, 1/59.
64. E ka regjistruar Tirmidhiu dhe në fund të tekstit: “përderisa nuk bëhet mëkat.”
 Te Buhariu “gjithmonë në mes dy çështjeve”.
 Te Maliku “në dy çështje”.
65. Transmeton Buhariu nga Aishja.
66. E ka regjistruar Ahmedi në musnedin e tij nga hadithi i Xhabir bin Abdullahut dhe nga hadithi i Ebi Umames.
 E ka regjistruar Hatibi.
 E ka transmetuar Dejlemiju në musnedin e Firdevsit nga hadithi i Aishes r.a. (“el-Mekasid”, 109).
67. E ka regjistruar Buhariu dhe Nesaiu nga Ebi Hurejrete r.a. (“Xhamiul Usulë”, 1/214).
68. “Fetava”, 1/78, shejh Alishë.
69. “el-Ihkam”, 2/167.
 “Irshadul Fuhulë”, 234.
70. “Usulul Fikh”, 387, prof. Muhamed Ebu Zehra.
71. “Umdetu Tehkikë”, 124, Benaniju.
72. “el-Amediu”.
 “Irshadul Fuhulë”.
73. “el-Amediu”, 73.
74. “el-Amediu”.
 “Irshadul Fuhulë”.
 “Muslimu Thubutë”.
 “Fevatihu Rahmutë”.
 “Et-Tekrirë vet-Tehbirë”.
 “Sherhul udadi ala muhtesar Ibni Haxhib”.
 “Sherhul mehalij ala xhemi xhevamiu”.
 “Sherhul Esnevi”.
 “Usulul Fikhi”, 373, el-Hudriji.

75. “Muslmu Thubut”.
 “Fevatihu Rahmut”.
 “Iëlamul mukiijn”.
 “Sherhul Esnevi”.
 “Umdetu Tehkikë fit-teklidë vet-telfikë”.
 “Tuhfetu reëji Sedidë”.
 “Mevahibul xhelilë sherh muhtesar halilë”, 1/31.
76. “Usulul Istinbat”.
 “El-anavijn fil mes’eletil Usulijeti”.
 “Usulul ameti lil fikhil mukaren”.
77. Ibid.
78. “Iëlamul mukiijn”, 4/216.
 Ibn Kajimi, në lidhje me këtë çështje i ka përmendur dy anët e studentëve Shafii dhe të Ahmedit:
 E para: Nuk lejohet – sepse po të jetë gjallë është e mundur të ndërroj mendje.
 E dyta: Lejohet – dhe ai mund të veproj duke pasuar të gjithë në fytyrën e tokës.
79. “Usulul ameti”, 656.
80. “Umdetu Tehkikë”, 81.
81. Qëllimi me “istiftaë” është kur pyetet muxhtehidi për një dispozitë për të vepruar me mendimin e tij, pa marrë parasysh se a është i pyeturi muxhtehidë ose që raporton drejtë, qoftë nëpërmjet ndërmjetësimit (“Tuhfetu reëji sedidë”, 63).
82. “el-Ihkam”, 3/171, el-Amediu.
 “el-mustesfa”, 2/125, el-Gazaliu.
 “Irsadul Fuhulë”, 239, 139.
 “Et-Teksiretu”, 1/57, Ibni Ferhunë, 1/57.
83. “el-Amedi”, 3/173.
 “Muslimu Thubutë”, 2/354.
 “Fevatihu Rahmutë”, 2/403.
 “et-Tekrirë vet-Tehbirë”, 2/345.
 “Revdatu Nadhir”, 2/452.
 “el-Lemë”, 68, Shiraziju.
 “Risalete fi usuli Dhahirijeti”, 32, Ibni Arabij.
 “Usulul Fikh”, 372, El-Hudrij.
 “el-med’hal ila medhheb Ahmed”, 194.
 “et-Teksirete”, 1/57.
 “Fetava”, 1/61, shejh Alish.
84. “el-mustesfa”.
85. “Usulul ameti lil-fikhil mukaren”, 659.
86. Ibn Bedran el Hanbelij në librin “Med-hal” ka thënë: Absolutisht nuk lejohet që pasuesi të pyes më të mirin e muxhtehidëve sepse kjo e mbyll derën e pasimit. Përderisa, nëse e përkufizojmë me muxhtehidin e qytetit, atëherë duhet ta zgjedhë më të mirin sepse mund të kuptohet dhe të dihet se cili është më i miri i qytetit. Nëse pyetësi pyet dy e më shumë muxhtehidë, për këtë çështje dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme, por mendimi më i drejtë është se duhet të ndjekë më

- të mirin. Shejh Alishi në librin “el Fetava, 1/73” ka thënë: E vërteta është që të merr mendimin e më të diturit sepse kjo është më e arsyeshmja.
87. “Usulul ameti lil fikhil mukaren”, 620.
88. Transmeton Ebu Davudi dhe Tirmidhiu nga Abdurrahman bin Amr es-Selmiju ve Huxhr bin Haxheri, 1/187, “Xhamiul Usulë”.
89. Në “Meleë fi siretu Alij” në hadithin merfuë nga Ibni Abasi: Më i mëshirshmi i umetit tim për umetin tim është Ebu Bekri.
Transmeton AbduRrezaku, mursel, nga Katade.
Transmeton Tirmidhiu, merfuë nga Enesi, ai thotë se hadithi është i mirë dhe i saktë dhe është hadithë meshurë. Teksti i hadithit është: “Më i mëshirshmi i umetit tim për umetin tim është Ebu Bekri.”, ndërsa më rigoroz i urdhrat e Allahut është Umeri, më i turpshmi është Uthmani, më i dituri për hallallet dhe haramet është Muadh bin Xhebeli, për shkencën e feraidit Zejd bin Thabiti, për lexim të Kur’anit Ubeje dhe për secilin umet ka besnik, e besniku i këtij umeti është Ebu Abijdete (“el-mekasidul hasenete”, 47-72, “Sehaviju, el-fet-ul Kebirë”, 1/172).
90. “el-Ihkam fi usulul Ahkam”, 3/173-174.
91. Tebsiretul Hukam, 1/59, Ibni Ferhunë ka thënë: Të ngarkuarit janë dy llojesh:
- Muxhtehidit,
- dhe ai i cili nuk është muxhtehidë.
Ligji e parasheh që të merren për bazë mendimet e muxhtehidëve të drejtë. Ligji e parasheh mendimin e muxhtehidit si bazë ligjore, nëse është e domosdoshme të veprohet. Për këtë janë pajtuar të gjithë.
92. “el-mustesfa”, 1/100.
“el ihkam”, 1/180, el-Amediju.
93. “el-mustesfa”, 2/125.
“el-Ihkam”, 2/171, el-Amediu.
“Muslimu Thubutë”, 2/352.
“Usulul Fikhi”, 371, el-Hudriju.
“Usulul ameti li fikhil-mukaren”, 669.
94. Transmetohet se pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: Unë frikësohem për umetin tim pas meje për tri çështje.
Cilat janë ato o i dërguar i Allahut?
Është përgjigjur: Frikësohem nga mungesa e dijetarëve, nga qeveritari i padrejtë dhe nga pasimi i epshit.
Nga Umeri: Tri çështje e shkatërrojnë fenë:
- Humbja e dijetarëve.
- Hipokriti polemizues me Kur’an.
- Udhëheqësit e devijuar. (“el-muvafekat”, 4/178).
95. “Usulul Fikhi”, shejh Muhamed Ebu Zehra, 390.

Përmbajtja:

Hyrje	4
<i>Tema e parë</i>	5
- <i>Definicioni i pasimit,</i>	5
- <i>Historia e pasimit,</i>	5
- <i>Dallimi ndërmjet pasimit dhe ndjekjes.</i>	5
Definicioni i pasimit.....	6
Historia e pasimit	6
Dallimi ndërmjet pasimit dhe ndjekjes	7
Tema e dytë.....	8
- <i>Sfera e pasimit,</i>	8
- <i>Dispozita e pasimit,</i>	8
- <i>Llojet e pasimit dhe</i>	8
- <i>Sqarimi i pasuesit.</i>	8
Pasimi në çështje të besimit ose në bazat kryesore	9
Pasimi në çështjet dytësore	13
Llojet e pasimit.....	18
Pasuesi	20
A duhet të pasoj muxhtehidi?	21
Mendimi im (i autorit) për pasimin.....	24
Tema e tretë: Përmbajtja e pasuesit në një medhheb të caktuar	26
A lejohet (pasuesi) t'i përmbahet medhhebit, i cili medhheb është pjesërisht në kundërshtim me imamin e tij?	28
Pasimi i një medhhebi tjetër përpos njërit prej katër medhhebeve ...	29
Tema e katërt: Përzierja (TELFIKI) e medhhebeve dhe ndjekja e lehtësimeve	31
Fusha e përzierjes (telfikit).....	33
Ligjësimi.....	33

Përzierja (telfiki) e ndaluar	38
Dispozita e telfikit në obligimet e sheriatit	40
Pasimi i lehtësimeve	44
Tema e pestë: Çka ekziston në mes të pyetësit dhe muftisë dhe kushtet e të pasuarit	47
Fetvaja e muxhtehidit i cili nuk është muxhtehidë i medhhebit të ndonjë imami	49
Kushtet e të pasuarit	51
1. Kushti i gjallërisë për muxhtehidin që pasohet	51
2. Dituria e të pasuarit	54
Drejtësia e muftisë (të pasuarit)	59

